

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISORË (VSM)

PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL TË
KLINËS



PËRMBAJTJA

HYRJE	7
KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	8
Direktiva VSM e BE-së	8
Direktivat e tjera të BE-së	8
Strategjia 2020 e BE-së	8
Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB	9
Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit	9
Konventa Århus	9
Konventa ESPOO dhe Protokolli i Kievit	9
Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse	10
Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor	10
Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)	10
Planet dhe programet e tjera të rëndësishme	11
POZITA GJEOGRAFIKE	13
KUSHTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE	14
Hipsometria dhe topografia	14
Gjeologjia dhe tokat	14
Kushtet klimatike	15
Hidrografia	16
Flora dhe fauna	16
Zonat e mbrojtura	16
Rreziqet natyrore	19
KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE	20
Ndarja administrative	20
Popullsia	20
Shfrytëzimi i tokës	21
Bujqësia	24
Turizmi	24
Infrastruktura rrugore	25
Infrastruktura e energjisë elektrike	26
Infrastruktura e ujësjellësit	27
Infrastruktura e kanalizimit	30
ANALIZA SWOT	32
Zonat me Probleme Mjedisore	32
Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore	32
Argumente të Analizës SWOT	34

Pikat e forta	34
Pikat e dobëta	34
Mundësitë.....	34
Kërcënimet.....	35
Analiza AWOT.....	36
VIZIONI DHE SKENARET E ZHVILLIMIT	38
Shkalla që PZHK-ja ndikon në planet e tjera	42
Disa nga aspekte kryesore të gjendjes aktuale mjedisore.....	42
Popullsia dhe shëndeti publik.....	42
Shëndeti.....	43
Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin	43
Zona të mbrojtura.....	44
Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale.....	44
Pyllzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e blerta dhe të pushimit	44
Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik	44
Biodiversiteti, Flora dhe Fauna.....	45
Tipet e Habitave	45
Rreziqet natyrore në mjedisin fizik	47
Mjedisi i ndërtuar dhe kultura.....	48
Cilësia e ajrit.....	48
Zhurma dhe Kundërmimi	50
Burimet ujore dhe furnizimi me uje	51
Çështje mjedisore që lidhen me ujin e pijshëm	52
Grumbullimi i mbetjeve të ngurta	53
Menaxhimi i mbetjeve të lëngëta dhe kullimi i ujërave të shirave.....	52
Furnizimi me energji.....	54
Aktivitetet ekonomike dhe sociale	54
PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QE KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL	56
Parimet e përgjithshme për planifikim hapësinor	56
Objektiva strategjike	56
Veprime operacionale në mbështetje të objektivave strategjike	58
Kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal	59
Kritere të forta mjedisore-shëndetësore.....	59
Kritere të trashëgimisë kulturore	60
Kriteret peisazhike	61
Plani Zhvillimor Komunal i Klinës dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet Mjedisore	63
Konsiderata mjedisore në hartimin dhe përpunimin e Planit.....	63

Analiza e plotë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të PZHK-së.....	64
Masat e nevojshme në PZHK për Mbrojtjen e Mjedisit.....	70
Konceptet urbane të përdorimit të tokës, përfshi zhvillimin e qendrave.....	70
Ndikimi në klimë	70
Mbrojtja e pyjeve, zonave të gjelbra ekzistuese dhe zhvillimi i zonave të reja	70
Cilësia e ajrit	71
Propozimet për rrugë.....	71
Probleme të mjedisit në Klinë dhe përgjigja që jepet përmes PZHK-së.....	71
MONITORIMI.....	83
PERFUNDIME	87
LITERATURA	89

LISTA E SHKURTIMEVE

AKMM Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit

BE Bashkimi Evropian

KK Komuna e Klinës

GIS Sistemit i Informacionit Gjeografik

GNP Grimcat e Ngurta Pezull

NOQ Ndotsë Organike të Qëndrueshem

OBSH Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ Organizata Jo Qeveritare

OZHM Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

PZHK Plani Zhvillimor Komunal i Klinës

TeR Termat e Referencës

UNDP Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

UNEP Programi i Mjedisit të Kombeve të Bashkuara

VNM Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

VSM Vlerësim Strategjik Mjedisor

ZVM Zona të Veçanta të Mbrojtura

HYRJE

HYRJE

Hartimi i raportit të VSM-së për Programe, Plane Zhvillimore dhe Projekte të mëdha është detyrim ligjor. Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Klinës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikepamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e Planit Zhvillimor Komunal.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis“ dhe ligjin për Vlerësimin Stragjik Mjedisorë, i cili është transpozimi i direktives së BE 2001/42/EC.

Mbeshtetur në samësiper VSM-ja duhet të përfshijë pikat e mëposhtme:

- Një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
- Përshkrim të Vizionit, prioritet dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal të Klinës dhe marrëdhëniet e tij me politikën, Planin dhe Programet e tjera që kanë lidhje me të;
- Përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk zbatohet plani;
- Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
- Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me Planin dhe Programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;
- Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.
- Një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

Plani Zhvillimor Komunal për numurin e madh dhe diversitetin e gjerë të problematikës që trajton, kërkon konsultimin e një game të konsiderueshme dokumentacioni. Bëhet fjalë për plane, raporte, projekte, studime dhe literaturë teknike nga sektorë të ndryshëm ekonomik dhe social. Ky dokumentacion përvec materialeve që dispononte vete grupi hartues i VSM-s, u siguroi nga komuna e Klinës, institucione të tjera publike dhe kerkimet në internet.

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal është dokument i pari i llojit të tij që hartohet për këtë qëllim, dhe si i tillë besohet se do mundësojë që zhvillimet e ardhshme të jenë në harmoni me legjislacionin vendore të mjedisit, si dhe me direktivat dhe konventat ndërkombëtare.

KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Direktiva VSM e BE-së

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktivë nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlament i Evropian..., 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legjislative, rregulluese ose administrative.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

- Përgatiten e planeve për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & venditose hfrtëzim të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);
- Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejn një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmbledhet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merrën parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

Direktiva të tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke ushqyrtuar çështjet mjedisore dhe të. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedurë të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legjislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha¹ është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor me që bashkëpunimi rajonal me këtë rajonë është identifikuar si njëri prej prioritetëve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet e strategjisë janë “zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve dhe Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të që ndrueshmërisë, por nismat e tjera si *Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinia në lëvizje, Një agjendë përshkathësi dhe vende të reja pune dhe Platforma evropiane kundër varfërisë* dotë mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme sipër shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t'i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i

¹http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjëra tepër të rritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB

KB kan një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK në mënyrë që t'isigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në NjuJork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit². Janë 7 objektiva me qëllime specifike, një prej objektivave i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programete vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetë të sëpaku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit

Konventa Århus

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNE CE mbi Qasjen..., 1998) 'Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartoj në dis pozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhene efektive. Konventa parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat iposdojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave jo qeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;
- të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisorenë për gjithësi.

Konventa ESPOO dhe Protokolli i Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi..... Mjedisor, 1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Poashtu i

²http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenën dikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997. Siç thekson Marsden (2008).

Protokolli i Kievit është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqë dotë mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokolli është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën ESPOO, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësim i Strategjiki Mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (NMP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin qëndrueshëm. Protokolli poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokolli kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillimi rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzimi i tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse

Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjinr. 03/L-106), ndërkaq në korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (Qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 8 vjetëve dhe ta përfshijë një Plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Te gjitha nivelet e Planeve duhet te përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për secilin Plan obligohet përgaditja e raportit të VSM paralelisht me Planin.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin e zhvillimit urban në nivelin lokal të cilat duhet të jenë në harmoni me politikën dhe programet nacionale si dhe duke rrespektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)

Ligji Nr. 03/L-230 nënvizon rëndësinë e integritetit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të Planeve dhe të Programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e Planeve dhe e Programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato Plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM. Nëse mendohet që VSM nuk nevojitet vendimi për katë s' duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet t'i përfshijë arsyet e tij. Raport i VSM-së identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikime të mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i Planit ose Programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Kërkesat përcaktohen në Ligj në mënyrë që t'iu ofrojnë qasje në dokumente të VSM-së organeve këshilluese dhe

opinionit të përgjithshëm. Projekti i dokumenteve VSM-së është një dokument për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesa të posaçme për raste të këshillimeve ndërkufitare. Para se të aprovohet raporti VSM, ministria duhet ta shqyrtojë atë dhe të pajtohet me të. Po ashtu janë përcaktuar procedurat për informimin lidhur me aprovimin e vendimeve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen. Shtojcat e ligjit përmbajnë kritere të caktuara për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të ndikimeve në mjedis dhe informatat e nevojshme që duhet të ofrohen në raportet VSM si edhe kriteret për vlerësimin e raporteve të VSM-së.

Planet dhe programet e tjera të rëndësishme

Përveç legjislationit raporti i VSM-së duhet të merr parasysh edhe Planin Hapsinore të Kosovës 2010-2020+, Strategjinë për Mjedisin dhe Planin Veprimi në Mjedis, si dhe disa Plane, Programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE


POZITA GJEORAFIKE

Klina shtrihet në perëndim të Kosovës, veri-lindje të Rrafshit të Dukagjinit. Komuna e Klinës ka sipërfaqe prej . Kufizohet me këto komuna: Pejë, Istog, Skenderaj, Drenas, Malishevë, Rahovec dhe Gjakovë.

Pozita gjeografike dhe konfiguracioni mundëson që, Klina të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore. Nëpër Klinë kalon rruga magjistrale Prishtinë - Klinë - Pejë, rruga Klinë - Skenderaj - Mitrovicë, Klinë - Istog - Pejë, si dhe vijat hekurudhore Fushë Kosovë - Klinë - Pejë dhe Fushë Kosovë - Klinë - Prizren.

Nëpër territorin e Klinës, kalojnë pesë lumenj: Drini i Bardhë, lumi i Pejës, Klina, a dhe lumi i Istogut. Prej tyre katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e ujë nxënieve, do të mund të ujteshin deri në 2.000 ha tokë bujqësore.

Rreth 95% e tokës së përgjithshme është tokë bujqësore, ndërsa vetëm 4.9% është tokë jopjellore. Në strukturën e tokave bujqësore, dominojnë arat me 12.734 ha, pyjet me 12.735 ha, livadhet me 2.184 ha, kullosat 2.043 ha etj.³



³ <http://www.westmeansbusiness.com>

KUSHTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE

Hipsometria dhe topografia

Pozita, shpërndarja dhe shtrirja e vendbanimeve është rezultat i relievit dhe i elementeve të tjera të bazës natyrore-gjeografike. Nëse nisemi nga tërësitë relieviore gjeografike, në komunën e Klinës kemi vendbanimet të rrafshëta dhe vendbanimet në terrene të valëzuara. Vendbanimet e rrafshëta gjenden në pjesën fushore, luginave përgjatë lumenjve, buzë luginave, ose rrugëve kryesore ose anësore dhe janë më të përqendruara, ndërsa disa janë edhe në formë të zgjatur.

Prej numrit të përgjithshëm të vendbanimeve në komunë, vendbanimet të rrafshëta janë 12, përkatësisht 22.2%. Në kuadër të vendbanimeve të rrafshëta përfshihet edhe qyteti i Klinës. Vendbanimet në terrenet e valëzuara kodrinore, shtrihen kryesisht rrëzë kodrave, shpateve, dhe nëpër qafa. Në kuadër të tyre përfshihet shumica e vendbanimeve të komunës, 42 sosh, përkatësisht 77.7%.

GJEOLGJIA DHE TOKAT

Në territorin e komunës së Klinës janë hulumtuar rezerva të nevojshme për zhvillimin e mihjeve të mëdha të thëngjillit, të rezervave të boksitit, zhavorrit dhe argjilës për prodhim të tullave.

Thëngjilli

Shtresat e thëngjillit gjenden mes komunave Klinë dhe Istog. Terreni të cilin e përshkon është kodrinorë i ulët me lartësi mbidetare 400 – 500 m. Këto shtratimet të thëngjillit Klinë – Tuçep gjenden në pjesën veri-perëndimore të basenit të Pejës, që është edhe pjesë përbërëse e basenit të rrafshit të Dukagjinit. Nga hulumtimet, thëngjilli përfshinë një sipërfaqe prej 100 km². Hapësira në të cilën lajmërohet thëngjilli gjendet kryesisht ndërmjet hapësirës së Klinës në jug, Jashanicës në lindje, Tuçepit në veri dhe Drinit të Bardhë në perëndim.

Shtresat e thëngjillit gjenden në thellësi prej 0 – 23 m. Thellësia mesatare për tërë fushën Klinë – Tuçep është afro 140m. Pjesën e sipërme të shtresës së thëngjillit e përbëjnë: argjila e butë, argjila ranore kokërmirë, argjila laporit dhe laporcët.

Boksiti

Shtresat e boksitit gjenden afro 10 km në jug – lindje të qytetit të Klinës, në brez kodrinor. Ky territor përfshin një sipërfaqe prej 15 km².

Zhavorri dhe rëra

Shtratimi i zhavorrit gjendet 6 km në jug të Klinës, përkatësisht në territorin e fshatit Volljakë. Ky shtratim shtrihet në pjesën buzë bregut të djathtë dhe të majtë të Drinit të Bardhë dhe përfshinë një sipërfaqe prej 40 ha në bregun perëndimor dhe 20 ha në bregun lindor të lumit Drini i Bardhë.

Argjila për tulla

Shtratimi i argjilës gjendet 4 km në perëndim të qytetit të Klinës, përkatësisht në territorin e Jagodës, në afërsi të hekurudhës dhe 2 km larg rrugës Prishtinë – Pejë. Trashësia e shtratimit të argjilës sillet prej 6 – 18.6 m.⁴

⁴ Draft PZHK e Klinës

Kushtet klimatike

Temperatura e ajrit

Temperatura mesatare e ajrit ne Klinë është 10.8°C. Në korrik arrihet temperatura maksimale absolute prej 37.6°C ndërsa ne shkurt temperatura minimale absolute prej -11,8°C. Amplituda mesatare është 46,1°C.

Tabela 15. Rjedha mesatare maksimale dhe minimalee temperaturave të ajrit në Klinë është :

Muajtë	temp.mesatare	Ampl.max	Ampl.min	Amplitudat
janar	-1.1	12	-9.6	21.6
shkurt	0.1	11.5	-11.8	23,3
mars	7.9	24.3	-8.2	32.5
prill	11.3	27.5	-1.8	23,3
maj	16.2	28.5	3.2	31,5
qershor	18.3	33	8.9	41.9
korrik	21.1	37	9.1	46.1
gusht	19.7	32.7	9.7	42.4
shtator	18.5	31.5	5.8	37.3
tetor	10.7	29.3	-1.8	31.1
nëntor	5.1	20.5	-9.2	29.7
dhjetor	0.9	13.5	-8.2	21.7
vjetore	10.8	37	-11.8	46.1

Insolimi

Mesatarja vjetore e orëve të insolimit në Klinë nuk është matur mirëpo orientimisht mund të merren të dhënat për Pejë, për arsye të afërsisë së tyre dhe orientimit gati identik të terrenit.

Tabela Insolimi - Numri i orëve

Lokaliteti	I	II	III	IV	V	VI	
Pejë	105.9	129.4	144.5	206.1	176.4	204.8	
	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
	257.2	213.6	255	143.1	55	842	1973.

Tabela Vranësirat - Rjedha vjetore e vranësirave

Lokaliteti	I	II	III	IV	V	VI	
Klina	5.9	5.1	5.6	5.1	6.1	5.8	
	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
	4.7	5.3	2.9	5.5	7.6	6.2	5.5

Vranësira mesatare më e vogël për Klinë për muajin nëntor është 2.9 ndërsa mesatare vjetore është 5.5 të dhjetat e qiellit në Klinë.

Tabela Të reshurat -Lartësitë mujore e të reshurave

Lokaliteti	I	II	III	IV	V	VI	
Klina	12	4	38	45	40	60	
	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
	18	48	16	143	73	42	540

Vlera mesatare vjetore e të reshurave në Klinë është 540.0 mm, të reshurat më të mëdha janë në muajin tetor ndërsa të voglat më janar dhe shkurt.

TabelaNumri i ditëve në vit me të reshura

Lokaliteti	0.1	1,0	10,0	x 0,1	lartësiamax në vit
Klina	108	69	16	13	

Periudha e lajmërimit të borës është kryesisht prej muajit nëntor deri në prill. Është me rëndësi të thuhet se ky rajon për shkak të ndikimit të mediteranit i cili depërton me anë të lumit Drini i Bardhë, klima është e mjaft e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturë të ajrit gjatë vitit.⁵

Hidrografia

Nëpër territorin e Klinës, kalojnë pesë lumenj: Drini i Bardhë, lumi i Pejës, Klina, Mirusha dhe lumi i Istogut. Prej tyre katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e ujë nxënieve, do të mund të ujiteshin deri në 2.000 ha tokë bujqësore.

Flora dhe fauna

Komuna e Klinës ka një pozitë të mirë gjeografike me një hidrografi të pasur dhe shtrirje mjaft të madhe gjeografike, e cila përfshin zonat mesatarisht të larta dhe zonat e ulëta të terrenit. Në këtë komunë, sa i përket **fitodiversitetit** lidhur me llojet e bimëve këtu kemi mjaft llojllojshmëri të bimëve nga ato barishtore njëvjeqare dheri te ato shumëvjeqare dhe drunore apo brezat e pyjeve. Nga brezi i shpardhit me qarr (*Quercus frainettodhe Quercus cerris* shkon deri te brezi i ahut dhe shkozës. Brezi i pyjeve të shpardhit me qarr dhe bungbut janë brezi më i dëmtuar nga faktori njeri. Ndërkaq në zonat e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqërime mjaft të mëdha dhe të begatshme me lloje. Po ashtu, në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin ruderal përgjat rrugëve dhe vendbanimeve por, edhe barërat e kqia të cilat gjenden në tokat djerrina, në kufi të parcelave dhe në afërsi të gjerdheve.

Zoodiversitetit

Ihtiofauna: peshqit të cilët lajmerohen në këto ujëra janë: bërcaku, ngjala, mustaku, trofta e danubit dhe trofta projesh ne ujërat e Drinit të Bardhë,

Herpetofauna: Amphibiet- ujëtokësorët - bretkocat *Bufo bufo*, *Bufo viridis* *Rana rudibunda*, *Rana esculenta*, Salamandrat. Zvarranikët-breshkat, gjarprinjt dhe picraku.

Ornitofauna: nga shpezet lajmerohen: qukapikëthi i larmë, bilbili, kukuvajka, thëllënza, fazani, kumrija, krahëthata dhe mullizera . Shpezët sezonale të këtij territori janë gjeraqina, shkurtëza, borsi, gushkuqja, çyqja. etj.


Mamalia – gjitarët janë më të shprehur vjedullat, kunadhja, ketri, ujqit, vidrat dhe kaprojt.

Zonat e mbrojtura

Në komunën e Klinës ndodhen këto objekte dhe zona të mbrojtura të natyrës:

- ☐ **Burimii ujit mineral** në Dresnik, Klinë – monument natyror me karakter hidrologjik;
- ☐ **Gryka e lumit Klina**, Klinë –monumenti natyrës me vlera gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike
- ☐ **Trungu i qarrit** në Zllakuqan, Klinë –monument natyror me karakter botanik dhe turistik.
- ☐ **Trungu i rrënjës** në Deiq- monument natyror me karakter botanik
- ☐ **Komplesi i trungjeve të rrënjës** në Gllarevë- monument natyror me karakter botanik
- ☐ **Trungu i qarrit** në Nagllavkë- monument natyror me karakter botanik
- ☐ **Burimi i ujit mineral** në Rudicë- monument natyre me karakter hidrologjik
- ☐ **Trungu i bungut** në Ujëmirë- monument natyre me karakter botanik
- ☐ **Trungu i qarrit** në Poterq të ulët, Klinë – ish monument natyror me karakter botanik;
- ☐ **Trungu i qarrit** në Bërkovë, Klinë - ish monument natyror me karakter botanik
- ☐ **Parku rajonal i Mirushës**, Klinë, Malishevë, Rahovec–Kanioni, ujëvaret dhe peizazhet specifike, një fenomen natyror me rëndësi të jashtëzakonshme

⁵ Plani Zhvillimor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke



Harta Zonat dhe monumentet e mbrojtura (burimi :Pkani Hapësinor i Kosovës)⁶

Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës

⁶ Draft PZHK Klinë.

Rreziqet natyrore

Vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshri, akulli, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse te njerëzit, te shtazët dhe te bimët dhe fatkeqësi të tjera, që i shkakton natyra.

Fatkeqësitë e tjera nënkupton fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, ajror dhe hekurudhor, zjarret, fatkeqësitë në xeherore, shkatërrimi i digave dhe fatkeqësitë e tjera ekologjike dhe industriale, që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje, gjendja e jashtëzakonshme, emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjike te furnizimit me rryme, telekomunikacioni dhe teknologjisë informative, aktet terroriste dhe mënyrat e tjera të rrezikimit masiv. Territori i komunës së Klinës vazhdimisht është ballafaquar dhe mundë ballafaqohet me fatkeqësi natyrore dhe të tjera, kështu që Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtëje dhe Shpëtim ka përgjegjësi për menaxhimin e këtyre situatave emergjente, siç që janë:

- Zjarret
- Vërshimet
- Tërmetet
- Fatkeqësitë e tjera elementare

Njëra ndër fatkeqësitë natyrore më sfiduese është Tërmeti, dihet se në pikëpamje sizmologjike, Komuna e Klinës si edhe pjesa më e madhe e Kosovës paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete autoktone shumë të fortë, të cilët i kanë vatrën të cekëta.

Territori i komunës së Klinës hyn në 6°-7° (shkallë) të MSC. Është i evidentuar edhe ekzistimi i disa çarjeve të mbuluara apo pak të dukshme dhe mbulesave si dhe çarjeve të mbuluara gjë që tregojnë specificitetin e karakteristikave tektonike të këtij subregjioni. Këto zona të burimeve sizmike kanë gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojnë edhe në të ardhmen termete të fortë.

Sizmiciteti i lartë dhe tërmeti i 24 prillit 2002, që preku Rajonin Gjilan, mirëpo vlen të evidentohen edhe tërmetet e kohë pas kohshme të cilat ndodhin në vazhdimësi sikur edhe ato të datës: 06.03.2008 ku sipas Institutit Sizmik të Kosovës ishin tre tërmete edhe pse me shkallë të vogël të intensitetit prej 3.6, 3.4 dhe 3.7 shkallë të Rihterit.

Thatësira

Thatësia mundë të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla.

Vërshimet

Përmbytjet janë fatkeqësi elementare të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme. Përmbytjet konsiderohen dukuri të cilat paraqiten në sezone të caktuara, të cilat janë të rrezikshme për jetën e njeriut dhe sjellin dëme të konsiderueshme materiale. Përmbytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen. Uji i cili grumbullohet nga reshjet ose shkrirja e bores patjetër duhet ta gjejë një rrugë të lëvizjes së tij. Në këtë rast është e rëndësishme që atij t'i krijohen kushte për një shkarkim sa më të lirë pa pengesa. Komuna e Klinës vite me radhë ballafaqohet me problemin e vërshimeve si të lokaliteteve të banuara, ashtu edhe tokave bujqësore. Po ti bëhet një analizë e kësaj gjendje të shkaktuar nga këto vërshime mund të vijmë deri te këto konkluzione:

- a. *Dëmet ekonomike*
- b. *Rrezikimi i shëndetit të njeriut*
- c. *Ndotje permanente e ambientit*
- d. *Përhapje e epidemive etj.*

Në komunën e Klinës është me rëndësi të trajtohen ujërat që shkarkojnë përmbytje e që vinë si rezultat:

- I dëmtimit të argjinaturave të lumenjve dhe dëmtimi i shtratit të lumenjve.
- I përrenjve në zonat malore gjatë motit të lig me shira intensive bëhen shumë rrëmbyeshëm dhe të bartin material që e gjejnë në rrugën e tyre dhe kanë fuqi të madhe
- Në zonën e rrafshët ku për shkak të mungesës së pjerrësisë së terrenit uji të shiut ose nga bora e shkrirë nuk lëviz, por qëndron deri në momentin sa të thithet nga shtresa e tokës.

KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE

Ndarja administrative

Klina shtrihet në perëndim të Kosovës, veri-lindje të Rrafshit të Dukagjinit. Komuna e Klinës ka sipërfaqe prej 308.8 km², në të cilën shtrihen 54 vendbanime. Administrata komunale ndodhet në qytetin e Klinës i cili është edhe qyteti i vetëm në komunë.

Popullsia

Regjistrimi i fundit i përgjithshëm valid në Kosovë është bërë në vitin 1981 nga Enti i Statistikor i Kosovës. Në vitin 1991 është bërë edhe një regjistrim i përgjithshëm në Kosovë mirëpo të dhënat nga ky regjistrim duhet të merren me rezervë pasi që ai u bojkotua nga populli shqiptar. Në këtë gjendje të të dhënave statistiokre është vështirë të jepen vlerësime të sakta për numrin dhe strukturën e popullsisë në Kosovë.

Mungesa e të dhënave valide statistikore në Kosovë bëhet sidomos e ndjeshme pas lëvizjeve të mëdha të popullatës gjatë viteve nëntëdhjetë, si dhe gjatë dhe pas luftës. Pas çlirimit, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe vendore filluan të plotësojnë mungesën e të dhënave, përmes hulumtimeve dhe anketimeve të ndryshme. Duke qenë se në këtë proces janë përfshirë organizatat të ndryshme, nuk është arritur ndonjë standard konsistent i metodologjisë apo i cilësisë. Këto të dhëna e mbledhura nga organizatat ndërkombëtare, si dhe ato nga ESK mund të vlerësohen si pjesërisht të besueshme. Vlerësimet momentale janë se në Kosovë jetojnë rreth 2 milion banorë.

Situata nuk ndryshon shumë edhe për sa i përket të dhënave demografike për komunën e Klinës. Informatat për ndryshimet demografike pas vitit 1981 janë tejet të pakta dhe dhe pjesërisht të besueshme. Këtu duhet pasur parasysh se vlerësimet deri në vitin 1981 kanë të bëjnë me kufij të vjetër komunal të Klinës, para krijimit të komunës së Malishevës. Me krijimin e kësaj komune të re në vitin 1986, territori komunal i Klinës zvogëlohet nga 403 km² në 308.8 km². Ky fakt e bën më të vështirë krahasimin e nevojshëm të të dhënave demografike me periudhën para vitit 1981 si dhe projeksionet për të ardhmen. Si do që të jetë, informatat paravitit 1981 mund të na shërbejnë si një pasqyrë e përafërt e lëvizjeve demografike brenda Komunës së Klinës. Këto të dhëna dhe vlerësime janë plotësuar edhe me të dhënat e mbledhura dhe të sistemuara për nevojat hartimit të Planit Zhvillimor Urban të Klinës.

LËVIZJA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË BANORËVE

Kur flasim për ndryshimin e numrit të banorëve në Komunën e Klinës gjatë viteve të regjistrimit, periudhën 1948-1981 e trajtojmë si të veçantë për dy arsye:

- kjo periudhë është e mbuluar me regjistrime valide;
- regjistrimet përfshinë komunën e Klinës në kufijt para vitit 1986;

Prej vitit 1948 deri në vitin 1981 numri i banorëve të Komunës së Klinës u rrit nga 26090 në 54449 përkatësisht u shtua për 28359 banorë. Shkalla e shtimit gjatë kësaj periudhe ishte 2.3% ndërsa indeksi i shtimit ishte 208.7, vlera këto që janë më të vogla se vlerat përkatëse për Kosovën. Gjatë kësaj periudhe shtimi i përgjithshëm i popullsisë në komunë ishte më i vogël se shtimi natyror si pasojë e migrameve të popullsisë nga ky rajon.⁸ Aktualisht me regjistrimin e viti 2011 komuna e Klinës ka 38496 banorë, kurse qyteti i Klinës ka 5542 banorë.

⁸ Draft PZHK Klinë.

Shfrytezimi i tokës

Kategoritë e shfrytëzimit të tokës së komunës janë:

1. Vendbanimet
2. Toka e punueshme
3. Vegjetacioni i lartë
4. Zonat me interes të veçantë
5. Lumenjtë
6. Sipërfaqet për transport
7. Qendrat

1. VENDBANIMET

Sipërfaqja e vendbanimeve nënkupton sipërfaqen e ndërtuar të qendrës urbane Klinës, subqendrave, qendrave locale dhe fshatërave. Në kuadër të saj përfshihen banimi, infrastruktura sociale dhe fizike.

2. TOKA E PUNUESHME

Paraqet tokën e cila është e shfrytëzuar për :

- 2a) BUJQËSI- që paraqet zonën e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore: arë, kopsht, pemishte, livadh, kullosë si dhe tokat tjera shfrytëzimi optimal i të cilave përfshijnë prodhimin bujqësor dhe zhvillimin e blegtorisë duke marrë parasyh vetitë natyrore dhe kushtet ekonomike.
- 2b) KULLOSA- tokë e mbuluar kryesisht me vegjetacion natyror bimor e cila shërben për kullotjen, lëshuarjen dhe pushimin e bagëtisë.

3. VEGJETACIONI I LARTË

Këtu përfshihen të gjitha sipërfaqet mbi 0.2 ha të populluara në mënyrë të dendur me bimësi drunore.

4. ZONAT ME INTERES TË VEÇANTË

Janë zonat të cilat për vlerat që I kanë ose shërbimet që I ofrojnë janë më interes të posaçëm në nivel kombëtar:

- 4a) MONUMENTI I NATYRËS ‘MIRUSHA’- vlerë natyrore me interes kombëtar, resurs me potencial për zhvillimin e turizmit, speleoturizmit. Poashtu I rëndësishëm për zhvillimin e ekskurzioneve hulumtuese si për nevoja shkencore ashtu edhe ato arsimore.

- 4b) GRYKA E LUMIT KLINA- nënkupton vlerë natyrore të çmuar me potencial për zhvillimin e turizmit. Për shkak të karakterisitkave gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike I rëndësishëm edhe për nevoja arsimore.

- 4c) RESURSET NËNTOKËSORE- rezerva të nevojshme për zhvillimin e mihjeve të mëdha të thengjillit, të rezervave të boksitit, zhavorrit dhe argjillës për prodhimin e tullave. Gjithashtu edhe të pllakave të gurit si identifikuese të komunës së Klinës.

- 4d) Manastiri i Budislacit

- 4e) Manastiri i Dollcit

- 4f) Hermitazhi me kishë apo Kisha e heremitëve

5. LUMENJTË

Të gjitha ujërat sipërfaqësor të vazhdueshëm ose peridik siç janë: lumenjtë, pellgjet, liqenet dhe sipërfaqe të ngjajshme.

6. SIPËRFAQET PËR TRANSPORT

Sipërfaqet për transport përbëhen nga korridoret për transport:

- 6a) Rrugët nacionale- janë korridore të cilat lidhin Kosovën me vendet fqinje.

6b) Rugët rajonale-nënkupton rrugën publike që lidh dy ose më shumë qytete të mëdha

6c) Rugët kryesore lokale-janë rrugët publike që lidhin qendrat e bashkësive lokale brenda komunës së Klinës.

6ç) Rugët lokale-janë rrugët publike që lidhin vendbaimet me rrugën kryesore lokale brenda komunës së Klinës.

6d) Rugët malore- shfrytëzohet për mirëmbajten dhe monitorimin e zonave malore, pyjeve si dhe për zhvillimin e turizmit.


6dh) Rugët turistike- paraqet rrugën publike që lidh pika të rëndësishme atraktive natyrore dhe kulturore në territorin e komunës.

7. QENDRAT

7a) Qendra kryesore- paraqesin qendrat urbane ku gjenden të gjitha shërbimet në nivel komunal

7b) Subqendra- janë qendra lokale ku ofrohen veprimtaritë shërbyese të decentralizuara me qëllim të zvogëlimit të qarkullimit të panevojshëm në drejtim të qendrës kryesore-Klinës, për shërbimet të cilat mund të ofrohen në kuadër të subqendrave.

7c) Qendrat lokale- janë qendrat e bashkësive lokale ku ofrohen shërbimet në nivel të bashkësisë lokale.



Harta..... Shfrytëzimiitokës.⁹

⁹ Draft PZHK Klinë.

Tradhëgimia kulturore

Pozita e favorshme gjeografike toka pjellore hidrografia e Komunës së Klinës mundësuan jetesën dhe zhvillimin e kulturave të krijimtarisë njerëzore që nga epoka e neolitit kundrejt vazhdimësisë deri në ditët e sotme.

Gjurimet e para arkeologjike me karakter sistematik janë ndërmarrë në vitin 1978, në fshatin Përçevë, me ç'rast nga 19 kodërvarre të evidencuara 7 sosh janë hulumtuar në tërësi. Në vitin 1983 në ekspeditën përnjohëse të pjesës qendrore të Rrafshit të Dukagjinit u përfshi edhe Jashanica e Epërme, ku u evidencuan vendbanimi shumë shtresorë i epokës parahistorike, një kodërvarr ilir dhe themelet e një kishe mesjetare një nefeshe. Gjatë viteve 1996 – 1991 tehu i gjurmime arkeologjike ka qenë i përqendruar në varrezën ilire të epokës së bronzit të vonë në fshatin Gllarevë, ku janë zbuluar gjithsej 44 varre. Gjatë viteve 1993,1994 në vendbanimin e fortifikuar shumë shtresorë të fshatit Dollc janë ndërmarrë konservime dhe restaurime të mureve antike dhe të objekteve mesjetare, me ç'rast përfundi shtresave antike janë zbuluar enë fragmentare të epokës së neolitit.

Kërkimet e fundit në komunën e Klinës janë ndërmarrë gjatë vitit 2000. Ato kishin për qëllim sigurimin e të dhënave elementare lidhur me përfaqësimin e lokaliteteve arkeologjike, skicimin e planimetrisë së vendbanimeve të fortifikuara sikurse edhe gjurmimet arkeologjike me karakter sondazhi në Pogragjë. Në fazën e sotme të gjurmimeve të kufizuara arkeologjike nuk mund të jepet një pasqyrë e plotë e vend zbulimeve arkeologjike, përfaqësimit e shtresimeve në secilin lokalitet veç e veç, mirëpo duke u mbështetur në gërmimet e bëra arkeologjike dhe në rezultatet e përnjohjeve të kohëpaskohshme që janë ndërmarrë në komunën e Klinës mund të jepet një pasqyrë e përgjithshme.

Harta12. Zonat e mbrojtura¹⁰

ZONAT ME INTEREST TË VEÇANTË

Janë zonat të cilat për vlerat që i kanë ose shërbimet që i ofrojnë janë më interes të posaçëm në nivel kombëtar:

MONUMENTI I NATYRËS “MIRUSHA”- vlerë natyrore me interes kombëtar, resurs me potencial për zhvillimin e turizmit, speleoturizmit. Poashtu I rëndësishëm për zhvillimin e ekskurzioneve hulumtuese si për nevoja shkencore ashtu edhe ato arsimore.

GRYKA E LUMIT KLINA- nënkupton vlerë natyrore të çmuar me potencial për zhvillimin e turizmit. Për shkak të karakterisitkave gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike I rëndësishëm edhe për nevoja arsimore.

RESURSET NËNTOKËSORE- rezerva të nevojshme për zhvillimin e mihjeve të mëdha të thengjillit, të rezervave të boksitit, zhavorrit dhe argjillës për prodhimin e tullave. Gjithashtu edhe të pllakave të gurit si identifikuese të komunës së Klinës.

- Manastiri i Budislacit
- Manastiri i Dollcit
- Hermitazhi me kishë apo Kisha e heremitëve

¹⁰Plani hapësinor i Kosovës dhe Draft PZHK Klinë

Bujqësia

Ekonomia e Klinës është e bazuar në veprimtarinë bujqësore dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore. Bujqësia si aktivitet ekonomik është e bazuar në kushtet e mira të tokës bujqësore, pasurisë me rrjedha ujore si dhe të reshurave të cilat në Klinë janë në sasi të volitshme. Në komunën e Klinës 87.7% e tokës është nën 600 m lartësi mbidetare, ndërsa 95% është tokë pjellore. Disa ndërmarrje industriale – bujqësore të periudhës së paraluftës, tani janë në fazën e privatizimit.

Turizmi

Komponentja natyrore dhe ajo sociale e bëjnë komunën e Klinës si një Vend me pasuri të begatshme dhe interesante për tu vizituar dhe shijuar siç janë lugina të lumejve resurset natyrore si ujëvarat e Mirushës dhe shpellat, trashëgimia kulturore–kullat, mullinjtë, xhamitë, kishat, etj. Përbëjnë potencialet për zhvillimin e turizmit. Edhe pse ende i paorganizuar në nivelin qendror dhe atë lokal, turizmi në komunën e Klinës ka potencial të mjaftueshëm për t’u bërë një veprimtari e rëndësishme ekonomike.

Për të pasur një zhvillim të mirëfilltë të turizmit, lokacionet me resurse dhe atraksione natyrore, siç janë fauna dhe flora-peizazhet, shpellat, pyjet dhe klima, duhet të merren në konsiderim për alokimin e investimeve. Faktorët e krijuar si transporti, konkurrenca, historia, qasja në tregje dhe karakteri i komunitetit, kanë po ashtu rolet e rëndësishëm në zhvillimin e turizmit. Zhvillimi i turizmit si veprimtari ekonomike në territorin e komunës, dallohet për nga tipet e përcaktuara sipas potencialit: në zonën “bujqësore” dhe në zonën e kombinuar ku resurs kryesor është peizazhi për rreth lumejve dhe motivet turistike të turizmit rural, ka mundësi të zhvillohet agroturizmi dhe turizmi rural bazuar në tokën bujqësore. Po ashtu, në bazë të trashëgimisë kulturore mund të zhvillohet edhe turizmi kulturor në zonën pyjore mund të zhvillohet turizmi natyror–ose ekoturizmi bazuar në motivet turistike natyrore si Monument i natyror “Mirusha” gryka e lumit Klina, pasuri të tjera të trashëgimisë natyrore si dhe spjeloturizmi në shpellat e kanionit të Mirushës.

Turizmi në komunën e Klinës duhet të bazohet në kërkesat e shfrytëzuesve/vizitorëve, duke mos i cenuar veprimtari të tjera ekonomike, posaçërisht agrikulturën si shtyllënkryesore të zhvillimit ekonomik, si dhe natyrën dhe peizazhin gjithashtu. Turizmi duhet të mbështetet në potencialin agrikulturor lokal duke shfrytëzuar produktet kualitative bujqësore për ta begatuar ofertën turistike.

Produkti final që dërgon kënaqë shfrytëzuesin/vizitorin, varet në masë të madhe nga kualiteti i shërbimeve dhe prezantimi i atraksioneve natyrore, objekteve turistike–hoteliere, komuniteti, qasja dhe mobiliteti. Aktorët kryesor të cilët duhet ta zhvillojnë turizmin duhet të jenë bordi lokal i turizmit, ndërmarrjet komerciale si agjencitë turistike dhe individët e aftë në këtë veprimtari. Për organizim të mirëfilltë të kësaj industrie, duhet të krijohet një bord i përbërë nga aktorët kryesor në këtë industri me qëllim të krijimit të standardeve, mbrojtjen e interesave ekonomike, përfshirë këtu bizneset, turistët, komunitetin dhe interesat ambientale e kulturore. Bordi do të ndërtojë edhe bazë të dhënave për motivet turistike në territorin e komunës dhe më gjerë, akomodimi me klasifikimin e përcaktuar nga MTI si aktivitete specifike që mund t’u ofrohen klientëve. Janë tri elemente të cilat mund t’i japin drejtimin e duhur zhvillimit të ardhshëm të turizmit në komunën e Klinës.

Infrastruktura rrugore

Pozita natyrore dhe topografia mundëson që Klina të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore. Nëpër Klinë kalon magjistralja Prishtinë-Pejë e cila ka rëndësi të veçantë në nivel të Kosovës. Në Klinë gjithashtu gjendet nyja hekurudhore e cila rangohet si e dyta me rëndësi për territorin e Kosovës, pas nyjes hekurudhore në Fushë Kosovë.

Trafiku dhe transporti rrugor - Rrjeti rrugor përbëhet prej rrugëve që kategorizohen nëmagjistrale, regjionale dhe lokale. Rruga magjistrale dhe ato regjionale paraqesin vijat kryesore të qarkullimit dhe lidhjeve brenda komunës dhe në pjesën më të madhe shtrihen në terrene të rrafshëta apo përgjatë luginave. Ndërkaq, rrugët lokale kanë një shtrirje të lirë në mes vendbanimeve, duke iu përshtatur kushteve natyrore që ofron hapësira e Klinës.

Magjistralja Prishtinë - Pejë paraqet arterien kryesore të qarkullimit rrugor, që në territorin e komunës shtrihet kryesisht në drejtimin lindje-perëndim, duke e ndarë atë në dy tërësi. Kjo magjistrale mundëson lidhje me pjesët qëndrore dhe lindorë të Kosovës, duke e përfshirë edhe kryeqytetin, ndërsa përmes degëzimeve të mëtutjeshme mundëson lidhje me shtetet fqinje, Maqedoninë dhe Serbinë. Në drejtimin perëndimor, magjistralja mundëson lidhje me Pejën si qendër regjionale, si dhe me Malin e Zi në vazhdim. Në të ardhmen, kjo magjistrale do të mundësojë edhe lidhjen me autostradën Durrës - Merdarë, në drejtimin verilindor.

Përveç në segmentin në mes fshatrave Gllarevë dhe Dollc, ku magjistralja kalon nëpër pjesë kodrinore, në pjesët tjera kjo rrugë shtrihet në terren kryesisht të rrafshët. Pozita e Klinës, si qendër komunale, në raport me rrugën magjistrale është e përshtatshme, duke qenë se pjesa qendrore e qytetit është rreth 2.5 km larg saj, që mundëson një lidhje të shpejtë por njëkohësisht diskrete, larg ndikimeve nga trafiku i nivelit të lartë. Në pjesën perëndimore, përgjatë Lumbardhit

të Pejës, vendbanimet përgjatë kësaj magjistralejë janë më të shpeshta, që kërkon kujdes dhe kufizim të shpejtësisë së qarkullimit.

Rruga regjionale për Gjakovë kryqëzohet me rrugën magjistrale rreth 620m në lindje të kryqëzimit për qytetin e Klinës dhe është lidhja më frekvente në krahasim me drejtimet tjera regjionale brenda komunës. Shtrihet kryesisht në drejtimin veri - jug, përgjatë rrjedhës së Drinit

të Bardhë dhe pothuajse paralel me drejtimin hekurudhor për Prizren. Kjo rrugë regjionale mundëson lidhjen e Klinës me Gjakovën dhe Prizrenin, si dhe në vazhdim lidhjen me Shqipëri.

Në të ardhmen, kjo rrugë regjionale do të mundësojë edhe lidhjen me autostradën Durrës - Merdarë, në drejtimin jugor. Sa i përket zhvillimit të planifikuar të rrjetit rrugor brenda komunës, është paraparë që kryqëzimit për Gjakovë ti shtohet edhe drejtimi nga veriu, ku do të mundësohet qëkjo rrugë regjionale të vazhdohet edhe në veri të magjistrales, me ç'rast do të krijohet një drejtim tranzit i cili shtrihet në lindje të qytetit të Klinës dhe kyçet në rrugën regjionale për Skenderaj, rreth 1 km në lindje të zonës industriale.

Në pjesën veriore, deri në fshatin Qypevë, rruga regjionale për Gjakovë shtrihet në terren të rrafshët, duke qenë se këtë e mundëson hapësira e gjerë luginës së Drinit të Bardhë dhe vend- derdhjes së Lubardhit të Pejës. Në jug të Qypevës lugina e Drinit të Bardhë ngushtohet duke bërë që shtrirja e kësaj rruge të jetë përgjatë skajit lindor të saj, rrëzë terreneve kodrinore.

Rruga regjionale për Istog lidhet me rrugën magjistrale përmes zonës urbane të Klinës. Në pjesën më të madhe ka shtrirje në drejtim veriperëndimor, përgjatë rrjedhës së Lumbardhit të Pejës dhe Lumit të Istogut. Për shkak se shtrihet në terren të rrafshët dhe të përshtatshëm për banim, përgjatë kësaj rruge shtrihen disa vendbanime si dhe qasje nga to, për ç'shkak është i nevojshëm kufizimi i shpejtësisë në pjesë të caktuara.

Rruga regjionale për Skenderaj, lidhet me rrugën magjistrale përmes zonës urbane të Klinës, ky kryqëzohet me rrugën nga Istogu. Kjo rrugë mundëson lidhje me Skenderajin, Mitrovicën dhe me pjesët tjera të veriut të Kosovës. Në pjesën më të madhe shtrihet përgjatë terreneve kodrinore, kryesisht në drejtim verilindor.

Njësitë transformuese janë kryesisht të montuara në shtyllë metalike TSM dhe të montuara në shtyllë betoni TS B. Gjendja teknike e këtyre objekteve në tërësi nuk është e mirë, nga fakti se shumica e tyre janë të vjetërsuara dhe të mirëmbajtura jo si duhet.

Pjesa e telekomunikacionit është e kufizuar në 2000 lidhje të inkuorporuara në një central të tipit SI 2000. Nga kjo sasi fare pak janë distribuar në pjesën rurale. Rrjeti shpërndarës është ajror. Trasë të veqant ka diku rreth 60% të rrjetit egzistues telefonik, ndërsa pjesa tjetër shfrytëzon rrjetin distributiv.



Harta nr. Shpërndarja e rrjetit energjetik në Kosovë

Infrastruktura e ujësjellësit

Një ndër problemet më të mëdha të Komunës së Klinës është furnizimi i banorëve me ujë të pijshëm. Këto probleme janë për arsye shumica e vendbanimeve nuk furnizohen me ujë nga sistemet e ujësjellësit, por nga pusët dhe burime të pa kontrolluar. Probleme kanë edhe banorët që kanë rrjetin ujësjellësit përshka të cilësisë diskutabile të ujit.

Furnizimi me ujë i fshatrave

Furnizimi i vendbanimeve të komunës së Klinës bëhet nga:

- ☐ rrjeti i qytetit,
- ☐ sistemi i Jashanicës, që është i lidhurnë rrjetin ujësjellësit të qytetit dhe
- ☐ nga sistemi vetjake të vendbanimeve.

Pjesa tjetër e vendbanimeve furnizohen me ujë ashtu siç mundem dhe dinë: nga pusët individuale, burime individuale etj. Këto burime janë të pakontrolluar dhe shpesh të ndotura dhe me sasi të pamjaftueshme të ujit.


Familjet që furnizohen me ujë nga puset kanë probleme të mëdha me cilësinë e ujit e sidomos gjatë reshjeve kur uji ka mundësi të kontaminohet.

Pra siç shihet nga tabela më poshtë vetëm 24 ose 44.44% të vendbanimeve kanë ujë të pijes nga sistemi i ujësjellësit, kurse 30 ose 55.55% të vendbanimeve furnizimi me ujë të pijes e bëjnë në mënyrë individual e secila familje e bënë furnizim në mënyrën e vetë qoftë nga puset, burimet etj.

Vendbanimet të cilat janë të lidhur në sistemin qendror të qytetit që janë 15 ose 27.77%. Siç dihet problem i madh për këta banorë është se cilësia e ujit është shumë diskutabile. Prandaj banorët nuk e shfrytëzojnë këtë ujë për pije.

Sistemi i ujësjellësit Sferkë ka probleme teknike, prandaj mund të themi se nuk është në funksion.

Tek sistemet e ujësjellësit në Qeskovë, Kpuz dhe Grabanicë ka probleme me sasinë e ujit sidomos gjatë stinës së verës.



Harta nr. Rrjeti i ujësjellësit¹²

¹² Draft PZHK Klinë

Vendbanimet mesistemit e njëjës jellësit:

Zyra e vendit		VENBANIMI	MENYRA E FURNIZIMIT ME UJE	LLOJI I SISTEMIT
1. Klinë	1	Klina	Sistemi i ujës jellësit të qytetit	Ngazervuarin e ivjetër
	2	Dolc		
	3	Dresnik		
2. Jashanicë	1	Jashanica	Sistemi i ujës jellësinë Jashanicë	Ngazervuari ri
	2	Pograxha		
	3	Jelloci		
	4	Dushku		
	5	Ujmiri		
	6	Siqeva		
	7	Shtupel		
	8	Kërnice		
	9	Bingjë		
	10	Grapc		
	11	Dranashiq		
	12	Klinafc		
3. Sferkë	1	Sferkë	Sistemi i ujës jellësi Sferkë	Ngapusime pompa
	2	Dush		Ngapusime pompa
	3	Voljakë		Ngapusime pompa
	4	Qypevë		Ngapusime pompa
4. Furnizim nga burimet vetjake	1	Bërkovë		
	2	Qeskovë	Pusipublik	
	3	Kpuz	Pusipublik	
	4	Grabnicë	Pusetpublike	
	5	Gremnik	Burimi	
Furnizim individual	1	Zajm	Furnizim individual (secilanga familjet kanë patur furnizim vetjak)	Ngapuset, burimet etj
	2	Videjë		
	3	Deiq		
	4	Krushevëe Vogël		
	5	Gjurgjeviki Vogël		
	7	Jagodë		
	8	Budisalc		
	9	Rudicë		
	10	Krushevëe Madhe		
	11	Stupë		
	12	Nagllavë		
	13	Zllakuqan		
	14	Ranoc		
	15	Laskoc		
	17	Radulloc		
	18	Drenoc		
	19	Dubajevë		
	20	Pjetërqi Poshtëm		
	21	Pjetërqi Epërm		
	22	Bokshiq		
	23	Dollovë		
	24	Resnik		
	25	Gjurgjeviki Madh		
	26	Çabiq		
	27	Dobërdoll		
	28	Gllarevë		
	29	Rixhevë		
	30	Carravik		
	31	Zabërgjë		

Infrastruktura e kanalizimit

Vetëm 8 vendbanime të komunës së Klinëskanë rrjet të kanalizimit fekale:

1. Gremniku
2. Drenoci
3. Dushku
4. Çabiqi
5. Gllareva
6. Rixheva
7. Carraviku
8. Zabërgjë

Gremniku, Drenoci dhe Dushku kanë sistem të veçanta të kanalizimit, kurse Çabiqi, Gllavera, Rixheva, Carraviku dhe Zabërgjë janë të njëjtin sistem të kanalizimit.

Të gjitha këto vendbanimet ujërat e zeza i shkarkojnë në lumenjtë më të afërt pa ndonjë trajtim paraprakë. Pra, janë ndotës të drejtpërdrejt të lumenjve.

Në fshatrat tjerë ku nuk ka rrjet të kanalizimit, banorët shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë numër gropa klasike, nëpër jaze ose kanale sipërfaqësore, kurse shtëpitë ose grup shtëpish që kanë afër lumenj shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë drejt për drejt në lumë pa ndonjë trajtim paraprak.

Si në çdo vendbanim të Kosovë se dhe në Komunën e Klinës ndotja e ujit është e evidente. Ndotja më e madhe e lumenjve bëhet përmes lëshimit të drejtpërdrejt të ujërave të zeza të vendbanimeve dhe të objekteve industriale, pa ndonjë trajtim paraprak. Gjithashtu hedhja e mbeturinat të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve përbën një problem të madh.¹³

¹³ Draft PZHK Klinë

Analiza SWOT

Analiza SWOT

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundesi për përmirësim.

Zonat me Probleme Mjedisore

Ky seksion bën një përmbledhje të analizës së mësipërme të kushteve mjedisore në Klinë dhe vë në dukje:

- Zonat që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilave mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, nëse nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

Diskutim i grupeve të faktorëve në analizën SWOT.

Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor

Të gjithë lumenjtë dhe proskat, vuajnë degradim dhe ndotje mjedisore të shkaktuar nga depozitimi i vazhdueshëm i mbetjeve të ujërave të ndotura dhe i lëndëve të ngurta. Pastrimi i lumenjve të Klinës kërkon një menaxhim më të mirë të mbetjeve të ngurta, sidomos në vendbanimet e mëdha, si dhe sigurimin e kolektorëve të duhur gjatë rrugës. Eksploatimi i rrës dhe zhavorit nga shtrati i lumenjve në Komunën e Klinës paraqet një problem në vete, nga ky eksploatim degradohet i tërë ekosistemi i lumit (mikrozoobentosi dhe makrozoobentosi) si dhe ndrrohet edhe shtrati i lumit.

Nëse nuk kontrollohet rritja e numrit të automjeteve dhe nuk ndërmerren masa për të përmirësuar rrugët, standardet e karburanteve dhe të shkarkimeve, atëherë rritja eparashikuar me katër herë më shumë mjeteve do të ketë pasojë në cilësinë e ajrit. Masat e ndërmarra nga Qeveria për reduktimin e makinave të vjetra nëpërmjet taksimeve dhe renia e ritmit të ndërtimeve kanë dhënë efekte pozitive në ndotjen e ajrit, por janë të pamjaftueshme për të siguruar cilësi të ajrit dhe nivel të zhurmave brenda standardeve.

Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore

Gjatë planifikimit të rrugëve dhe zonave të reja apo objekteve tjera në Planin Zhvillim Komunal në radhë të parë duhet të ruhen zonat me vlera natyrore, objektet e mbrojtura të natyrës siç janë trungjet e vjetra dhe interesante për shkencën, gjeomunimentet dhe objekte tjera të cilat janë me vlera të veçanta për shkencën dhe kulturën.

Burimi i ujit mineral në Dresnik, Klinë – monument natyror me karakter hidrologjik;

- Gryka e lumit Klina, Klinë – monument i natyrës me vlera gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike
- Trungu i qarrit në Zllakuqan, Klinë – monument natyror me karakter botanik dhe turistik.
- Trungu i rrënjës në Deiq- monument natyror me karakter botanik
- Kompleksi i trungjeve të rrënjës në Gllarevë- monument natyror me karakter botanik
- Trungu i qarrit në Nagllavkë- monument natyror me karakter botanik
- Burimi i ujit mineral në Rudicë- monument natyre me karakter hidrologjik
- Trungu i bungut në Ujëmirë- monument natyre me karakter botanik
- Trungu i qarrit në Poterq të ulët, Klinë – ish monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i qarrit në Bërkovë, Klinë - ish monument natyror me karakter botanik

•Parku rajonal i Mirushës– Kanioni, ujëvaret dhe peizazhet specifike, një fenomen natyror me rëndësi të jashtëzakonshme.¹⁴

Ndërkohë që këto zona dhe objekte të mbrojtura të natyrës kanë duhet të jenë të mbrojtura në mënyrë institucionale dhe trajtim ose rishikim të statusit të tyre. Komuna dhe institucionet përgjegjëse përkëto zona duhet të marrin në konsiderat sugjerimet e PZHK-së për zonat me vlera të larta natyrore.

Duhet marrë vendime në lidhje me përdorimin e ardhshëm të tokës në zonat e parapara për vikende si dhe zonat tjera të pazhvilluara rreth vendbanimeve konform kufijve të propozuar ndërtimor.

Mjedisi i ndërtuar është një fushë tjetër shqetësuese. Monumentet kryesore të rëndësisë së Kosovës në Klinë do të vazhdojnë të ruhen, por ndërkohë duhet të merren vendimet në lidhje me atë se sa nga trashëgimia e ndërtimit në Klinë, e krijuar në periudha të ndryshme gjatë shekujve, do të ruhet. Këto vendime duhet marrë sa më parë, pasi komuna po transformohet me shpejtësi dhe mbushja e zonave të ndërtimeve tradicionale me godina mund të demtojë ose shkatërrojë vlerat e këtyre zonave.

Ajo që është e rëndësishme është se pjesa më e madhe e degradimit mjedisor të komunës nuk është i riparueshëm. Problemet mjedisore të identifikuara të menaxhimit të mbetjeve, të ngurta apo të lëngëta, si dhe ndotja e ajrit janë të trajtueshme në se investimet kryhen në kohe dhe në mënyrë efektive. Me këtë planë janë trajtuar:

I) furnizimin me ujë;

II) menaxhimin e ujërave të ndotura komunale;

III) trafikun; dhe është në proces menaxhimi i integruar i mbetjeve.

Ekzistojnë ndërkohë edhe legjislati dhe politikat përkatëse të cilat po zhvillohen me qëllim që t'u përgjigjen problemeve mjedisore. Potencialisht eksiston problem i ndotjes dhe i rënies së nivelit të ujërave nëntokësore për shkak të lumenjve të ndotur dhe të degraduar nga eksploatimi i rrës dhe zhavorit dhe pompimit të ujërave nëntokësore. Efekti i kësaj ndotjeje dhe i zvogëlimit të ujërave nëntokësore mund të jetë i vështirë për t'u parashikuar dhe riparuar.

Shqetësuese në komunën e Klinës janë eksploatimi i gurit apo edhe gurthyesit, të cilat në se vazhdon procesi i zhvillimit në këto ritme, do të shkaktojnë probleme të mëdha.

Nëse nuk ndalohen ndërtimet pa kritere në zonat e rëndësishme mjedisore, në mënyrë të veçantë, zhvillimi i cili po ndodh në rrethinë të disa vendbanimeve si në tokat me bonitet të lart ashtu edhe në zonat kodrinore, ndikon në aspektin biologjik, prishjen e zingjirëve ushqimor, ndërprerjen e korridoreve të rëndësishme për komunikim të ekosistemeve mes veti, si dhe në aspektin peizazhistik dhe mund të sjellë rritje të rrjedhjeve, gjë e cila mund të përshpejtojë proceset natyrore të erozionit dhe të shkaktojë rrëshqitje të tokës ose përmbytje.

Projektet të cilat janë realizuar më herët sidomos ato të infrastrukturës rrugore nuk janë përcjellë me vlerësim të ndikimit në mjedis, kështu duke rezultuar në degradim mjedisor në prishje të ashtuquajtura korridore të qarkullimit të shtazëve, vendstrehimit të tyre dhe duke i larguar përgjithmon disa lloje nga ky territor.

Deri më tani nuk rezulton të ketë studime që të lidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndikimin e cilesive se mjedisit, studime ka në nivel të përgjithshëm kryesisht për cilesin e ajrit, ujit të pishem, zhurmat, por jo vetëm, në shëndetin e banoreve.

Në raportet e nivelit qendror ofrohen në formë të përgjithësuar informata të sektorit shëndetësor në Kosovë, duke vënë në dukje çështje si siguria e ujit të pijshëm dhe siguria rrugore si shqetësime madhore, por në këto raporte nuk trajtohet në mënyrë specifike, ndërkohë që vë në pah edhe natyrën

¹⁴ Agjencioni për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës "Gjendja e natyrës– raport 2008-2009", Prishtinë 2010,

kontradiktore të disa prej treguesve shëndetësorë. Kto raporte që kanë edhe dimensionin mjedisor mundë shfrytëzohen për të rekomanduar që Qeveria e Kosovës dhe ajo komunale duhet të kalojnë nga ndërhyrjet me karakter kurativ në mjedis dhe shëndetësi, në ato me karakter parandalues. Raporti tregon se stili i jetës.

Agrumente të Analizës SWOT

Pikat e forta

Në komunën e Klinës ekzistojnë hulumtime të natyrave dhe fushave të ndryshme të cilat janë berë edhe në të kaluarën edhe tani ka një inventarizim të florës dhe faunës bukur të mirë, identifikim të problemeve mjedisore, ka analiza për ekosisteme bimore dhe ato shtazore kryesisht në mikro dhe zoobentos (nga studentët dhe studiues tjer) ka strategji të zhvillimit ekonomik lokal, Planinzhvillimior Urban dhe draft Planin Zhvillimor Komunal, Plani Lokal i Veprimt në Mjedis sidhe këtë dokument VSM) i cili analizon në mënyrë sistematike ndikemet potenciale mjedisore nga aplikimi i Planit Zhvillimor Komunal. Duke qenë komun me një turizë të zhvilluar, kjo komunë është në avantazh për shkak të Mirushës por edhe vetë si komunë si zona ekonomike dhe sociale me potenciale të konsiderushme të zhvillimit ekonomik, turistik, komunikimet(rrjeti nacional dhe nderkombetare i infrastruktures). Pika të forta janë edhe prezenca e kapaciteteve të zhvilluara intelektuale, kapacitetet rionore. Kemi edhe për çdo ditë e më shumë instalimin e teknologjive inovative dhe reduktim të dukshëm të industrive ndotëse. Legjislacioni mjedisor është drejt përafrimit me atë të Bashkimit Europian.

Pikat e dobëta

Shtrirja e vendbanimeve në zonat ku toka është e bonitetit të lart, poashtu edhe në zonat me vlera mjedisore. Koncentrimi i banorëve në disa fshatra por edhe në qendra për rreth rrugëve kryesore, kurse disa vendbanime po ballafaqohen me zbrastje nga banorët. Ndikimi i presionit të rritjes dhe zhvillimit në disa vendbanime tjera determinohen kryesisht me mungesën e vëndeve të punës, papunësisë dhe kulturës së jetesës, faktorë që duhen të manaxhohen.

Në planin administrues niveli i ulët i aftësive në segmente të administratës lokale ngadalëson kapacitetet manaxheriale. Probleme me pronën private të truallit, privatizimet, prania e hot spoteve mjedisore si ajo të miniera dhe në pikat tjera, mungesa e zbatimit korrekt të legjislacionit, veçanërisht atij mjedisor, krahas zhvillimeve të pa kontrolluara gjatë dy dekadëve të fundit, janë pjesë e pikave të dobëta në këtë analizë. Pika të dobta vazhdojnë të mbeten mangesite në trajtimin e trashëgimis kulturore, arkeologjike, të ndërtuar dhe natyrore, infrastrukturës, veçanërisht në furnizimin me ujë të pishem, kanalizimi i ujërave të zeza, mungesa e pastrimit të ujërave të zeza, manaxhimi i dobët i mbetjeve komunale, etj.

Mundësitë

Potencialin turistik që ka kjo komunë (Zona e lumit Mirusha)si dhe mbështetjen e mundëshme të donatorve dhe qeverise, është e mundur që komuna të vazhdojë të hartojë dhe zbatojë plane, programe dhe iniciativa të tjera për zhvillimin e studuar të pjesëve të trajtuar me këtë Plan Zhvillimor Komunal dhe trajtuara si zona për shfrytëzime të ndryshme, trajtimin e hapësirave të zgjeruarandërtimore të parapara me planë, hapsirave pyjore,peisazheve atyre rekreative dhe permiresimin e treguesve mjedisore. Në Planin Zhvillimor Komunal është e mundur të rritet ndjeshëm aplikimi i Ligjeve dhe Vendimeve të Kuvendit Komunal në favor të mjedisit dhe rritjes së financave publike komunale. Me qëllim të rritjes së hapsirave publike rekreative është e rekomanduar inkurajimi i biznesit privat në hapsirat rekreative (parqe, salla

lojrash, fusha sporti, sipërfaqe për femijët). Rritja e cilësisë së transportit publik është një mundësi që duhet të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme.

Kërcënimet

Humbja e vlerave të trashëgimis natyrore, Mos trajtimi i hot spoteve mjedisore (deponive ilegale të mbeturinave dhe mbetjeve tjera, vendeve të goditura me uranium të varfëruar nga lufta e fundit) mos trajtimi i zonave të mbrojtura, mos rikthimi i shtratit të lumenjve në gjendjen e më parshme duke i rregulluar edhe argjinaturat mundë të shkaktoj kërcnime serioze mjedisore dhe shëndetsore në komunën e Klinës dhe në rrethin pasi që ndotja dhe degradimi mjedisor nuk njohin kufij administrativ.

Humbje e vlerave natyrore, rekreative, shkencore dhe turistike, vendbanime të tëra të mbesin pa asnjë banor, kostoja e shërbimeve të ngritet deri në shkallën që shkakton trazira sociale dhe ekonomike. Problemi i pronësisë së tokës sidomos mungesat e pronave komunale për zhvillime përbejnë një grup problemesh shqetësuese ndikimi i të cilëve do të vazhdojë gjatë. Poashtu kërcënuese është edhe mungesa e financave komunale për të investuar në hapjen e parqeve dhe zonave për pushim dhe rekreim të njerëzve.

Analiza AWOT

Përparsitë Me PZHK jan trajtuar disa nga problemet dhe sfidat mjedisore Kushte të përshtatshme fiziko-gjeografik, turizëm i zhvilluar dhe burime natyrore kryesisht të mjaftueshme; Interesim ne rritje i qytetarve, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile për mjedisin Legjislacion mjedisor dhe planifikimi hapsinor i zhvilluar dhe përmirësuar; Prani e teknologjive inovative në procese industriale dhe ndërtimore; Kushte të mira të transportit të mallrave dhe njerzëve; Rritja e efektshmërisë së zbatimit të Ligjeve dhe detyrimeve financiare të popullsisë dhe biznesit në raport me taksat komunale; Përfshirja e ekipeve të kualifikuara në zbatimin e planeve dhe hartimin e projekteve të rëndësishme në kuadër të PZHK-së;	Dobësitë Mungesa e disa informatave për thellim të analizave për zhvillimet e planifikuara me PZHK. Shkall e lartë e ndërtimeve informale; Shpopullimi i zonave malore dhe përqëndrim i konsiderueshëm në zonat e ulta; Rrugë me përmbajtje jotë plotë (trotuar, parkingje, etj) Shkall e konsiderueshme nga ndotja e zhurmës dhe gazrave të djegjeve të brendshme motorike; Motivimi i ulët në segment të caktuar të administratës publike dhe qeverisjes lokale; Zvogëlimi i hapësirave të gjelbërta dhe hapësirave të tjera publike; Ndërtimi i banimit kolektiv pa norma të duhura urbanistike dhe ndërtimore; Mungesa e koordinimit me komunat për rreth; Infrastrukturë jo shumë e zhvilluar dhe e pintepruar (jo shumë funksionale); Manaxhim i dobët i mbeturinave; Mos trajtimi i hotspoteve mjedisore; Menaxhim jo i mirë i turizmit; Shkallë e ulët e të hyrave vetanake në buxhetin e komunës;
Mundësitë Planifikimi i masave për mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit; Gadishmërie donatorve dhe qeveris për trajtim të pikave të nxehta mjedisore; Zhvillimi i kapaciteteve manaxhuese të politikave, planeve dhe programeve në nivel komunal; Krijimi i një Forumi qytetar gjithë përfshirës për kualitet të jetës më të mirë, si njësi për opionencë dhe edukim mjedisor; Bashkëveprimi i kordinuar me komunat tjera; Ndërtimi i impjantit regjional dhe trajtimi i përkohëshëm në pikat e fundit të derdhjeve të ujit të përdorur. Përmirësimi i shërbimeve në transportin publik; Përfshirja e biznesit privat në hapsirat pyjore, të gjelbra dhe rekreative (parqe, salla lojrash, sipërfaqe për femijët).	Kërcënimet Rrezikimi i shëndetit të popullatës; Prishje e balancit mjedisor; Shkatërrimi i resurseve toksore, ujore dhe resurseve tjera; Shkatërrimi i ekosistemeve, biodiversitetit, florës dhe faunës; Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore; Konflikte në lidhje me çështjet e pronësisë; Pakësimi i hapësirave publike për shkak të presionit; Mungesa dhe/ose kosto e lartë për disponimin e sipërfaqeve të lira për projekte zhvillimore; Ulje e ndjeshme e biodiversitetit; Mungesa e koherencës midis aksioneve të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, donacioneve dhe departamenteve universitare/studiove profesionale etj.

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL

VIZIONI DHE SKENARET E ZHVILLIMIT

Vizioni i Komunës sëKlinës

“Zonë e zhvilluar kulturo-historike, agroindustriale dhe tregtare, zhvilluar në rrenjët dhe traditat e lashta, me qeveri locale të përgjegjshme dhe efikase, në bashëkpunim me qytetarët e saj dhe aktorët për zbatim të qëllimeve zhvillimore më shfrytëzim të resurseve natyrore dhe njerëzore, posaçërisht ën fushën e turizmit, afarizmit e bujqësisë”.

KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Gjatë identifikimit të problemeve dhe potencialeve në komunën e Klinës, janë identifikuar tri zona të ndryshme të cilat diferencohen në mesvete për kah karakteristikat agro-ekologjike, gjeomorfologjike si edhe për kah rrjet i hierarkikive të vdbanimeve bazuar në funksionin dhe ofrimin e shërbimeve dhe rrjetinë dhe lidhjet e trafikut me vendbaimet brenda dhe jashtë territorit të komunës.




Fig.....Koncepti

FUNKSIONET E ZONAVE

ZONA 1 - ZONA E TOKËS BUJQËSORE

Zona e bujqësisë karakterizohet me tokë bujqësore kualitative, boniteti i së cilës i takon klasës 2, 3 dhe 4 dhe me hidrografi të zhvilluar. Vetëm në këtë zonë kalojnë 3 lumenjtë kryesorë: Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës dhe lumi Klina. Shtrihet në një territor kryesisht rrafshinor me lartësi mbidetare prej 349-435m.

Kjo zonë mbulon afërsisht 17% të territorit të komunës në të cilën shtrihen numri më i madh i vendbanimeve. Nga 54 vendbanime sa e përbëjnë komunën e Klinës, 21 prej tyre janë të shtrira në këtë zonë. Në kuadër të kësaj zone gjendet qyteti i Klinës, si qendra kryesore administrative

dhe subqendra e Zllakuqanit, kudo të ofrohen shërbime të cilat ndikojnë në zhvillimin social dhe ekonomik të qendrave dhe vendbanimeve tjera.

Në këtë zonë kalojnë arteriet kryesore të qarkullimit rrugor, që në territorin e komunës së Klinës shtrihen në drejtimin lindje-perëndim dhe veri-jug.

Zgjerimi urban është në konflikt me agrikulturën përshkak të okupimit të tokës kualitative bujqësore, prandaj mbrojtja e tokës bujqësore duhet të konsiderohet si faktor i rëndësishëm gjatë alokimit të tokës për ndërtim. Bazuar në resurset, potencialet e zhvillimit dhe numrin e popullsisë që jeton dhe punon, kjo zonë është quajtur zona e bujqësisë.

Funksionet kryesore të zhvillimit për këtë zonë janë:

- Agrikultura–përfshi prodhimin dhe përpunimin
- Tregëtia
- Shërbimet kryesore

ZONA2-ZONA E KOMBINUAR

Karakterizohet me shumëllojshmëri të shfrytëzimit dhe potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Mbulon pjesën më të madhe të teritorit të komunës, rreth 55% në të cilën bëjnë pjesë 26 vendbanime. Shtrihet në një terren pjesërisht të ndryshueshëm prej 435-563 m, me tokë heterogjene, pjesërisht pyje dhe pjesërisht kullosa me potencial mesatar që kryesisht shfrytëzohet për prodhimtari blegtorale dhe kultura që ujiten me shira. Është Gllareva si subqendër ku do të ofrohen shërbime të cilat ndikojnë në zhvillimin social dhe ekonomik të qendrave të bashkësisë lokale dhe vendbanimeve tjera.

Sa i përket trafikut, në këtë zonë kalon rruga regjionale për Skendaraj, e cila mundëson lidhjen me Skenderajn, Mitrovicën dhe pjesët tjera të veriut të Kosovës.

Bazuar në karakterstikat, shumëllojshmërinë e mjedisit dhe potencialet e zhvillimit kjo zonë është quajtur zonë e kombinuar, ku zhvillimi ekonomik mbështetet në:

- Agrikulturë-blegtori
- Apikultura
- Agroturizmi dhe turizmi rural
- Turizmi kulturor


ZONA3-ZONAPYJORE

Zona e emëruar “zona pyjore” përfshinë vendbanimet që shtrihen kryesisht në pjesën jugore dhe juglindore, me terren kryesisht të pjerrët me lartësi maskimale 734 m. Kjo paraqet njëherit edhe zonën me lartësi më të madhe mbidetare të teritorit të komunës së Klinës, që përfshinë 28% të sipërfaqes së tërësishme të komunës në 7 vendbanime sa marrin pjesë në këtë zonë. Toka në këtë zonë i takon klasave 4-8. Njëra nga subqendrat që përfshihen në këtë zonë është Sferka, fshtati i dytë më i madh për nga numri i banorëve, në të cilin gjenden shërbimet kryesore sociale dhe ekonomike që e shërbejnë këtë zonë.

Në këtë zonë kalon rruga nacional e Prishtinë–Pejë, si arteria kryesore e qarkullimit rrugor. Potencialet dhe resurset natyrore dhe ato nëntokësore në këtë zonë mundësojnë zhvillimin e një numri të madh të veprimtarive ekonomike. Bazuar në këto veprimtari funksionet kryesore të zhvillimit në këtë zonë janë:

- Natyra dhe turizmi (Mirusha, gryka e Klinës, trashëgimia natyrore, lumenjtë)
- Speleoturizmi (shpellat në kanjonin e Mirushës)
- Pylltaria
- Ndërtimtaria (guri në Gllarevë, pasuritë nëntokësore, industria e drurit)

Z1	TOKË BUJQËSORE	Z2	E KOMBINUAR	Z3	TOKË PYJORE
Z1	-TOKË KUALITATIVE -HIDROGRAFI E ZHVILLUAR -PRODHIMTARI POTENCIALE -349-435 m -Klasa 2 -VENDBANIMET KRYESORE: Klina, Zllakuqani -LINJAT KRYESORE TË TRAFIKUT	Z2	-POTENCIAL PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË -PJESËRISHT PYJE -PJESËRISHT KULLOSA -435-563 m -Klasa 3 -VENDBANIMI KRYESOR: Ujëmiri -NEVOJË PËR PYLLËZIM	Z3	-PYJE -RESURSE NËNTOKËSORE- Pllakat gurore -MONUMENTI I NATYRËS "MIRUSHA" -GRYKA E LUMIT KLINË -563- 734 m -Klasa 4-8 -VENDBANIMI KRYESOR: Sferkë -NEVOJË PËR PYLLËZIM



QENDRAT DHE FUNKSIONET E TYRE SHËRBYESE

Qendrat e vendbanimeve sigurojnë përmbajtje dhe funksione të ndryshme të administratës, shërbime sociale dhe ekonomisë për banorët e vendbanimeve dhe për zonat e mbulimit apo shërbimit rreth tyre. Zgjerimi i shërbimeve ose zonës së mbulimit varet nga veçoria dhe kualiteti i hapësirave për vendosjen e shërbimeve të cilat duhet të arrihen në kohë të përshatshme të udhëtimit-arritjes. Kjo duhet të rezultojë me një hierarki qendrash me shkallë më të lartë apo më të ultë të përmbajtjeve dhe rrjedhimisht të zoanve më të vogla apo më të mëdha të shërbimit. Mirëpo, çdo qendër me numër më të madh të shërbimeve përfshinë edhe shërbimet e qendrave të shkallës më të ultë dhe menjë zonë më të vogël shërbimi.

Qëllimi i kësaj strukture qendrore të shërbimeve është sigurimi i shpërndarjes së përmbajtjeve shërbyese në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në një distancë të pranueshme të udhëtimit për të gjithë banorët e komunës së Klinës.

Kjo hierarki e vendbanimeve që funksionon përmes qendrave d.m.th qendrës kryesore, subqendrës dhe qendrës lokale, përbën bazën për marrjen e vendimeve për minimumin e funksioneve themelore shërbyese dhe vendosjen e objekteve për shërbimet shtesë, publike dhe private. Për të krijuar një rrjet funksional të vendbanimeve në komunën e Klinës, është propozuar shkallëzimi i vendbanimeve sipas funksioneve dhe numrit të banorëve të cilët ato ishërbejnë:

- Qendra kryesore-urbane, mbi 25.000 banorë
- Sub-qendra, 10.000-25.000 banorë
- Qendra lokale, 3000-10.000 banorë.

Në bazë të këtyre të dhënave, rrjeti i vendbanimeve të komunës së Klinës përbëhet nga:

- Qendra kryesore urbane-Klina
- Sub-qendra-Zllakuqani, Gllareva, Grabanica, Sferka
- Qendralokale-Budisalc, Ujëmiri, Shtupel, Jashanicë, Drenoc.

Kjo hierarki vendbanimesh duhet nënkuptuar në atë mënyrë që cdo subqendër por edhe qendra kryesore në të njëjtën kohë e luan rolin edhe të qendrave lokale për zonat që gravitojnë në to. Zona e mbulimit të një qendre përfshinë largësinë të cilët banorët e kalojnë për të arritur në përmbajtjet shërbyese që ofrohen aty. Zakonisht largësia e lëvizjes dhe koha janë faktorët kryesor që ndikojnë në vendimin e banorëve se në cilën qendër do të shkojnë (shkuarja në qendrën më të afërt paraqet një cilësi të funksionimit të shërbimeve) dhe kjo nënkupton zonën e mbulimit.

Tabela e më poshtme paraqet zona te mbulimit për funksione e cila varen nga distanca (udhëtimi dhe koha) si dhe qasja.

		Numril				shkollëfillore	shkollëe mesme	QKMF	QMF	Amulancë
		Qendra	Zona e mbulimit/shërbimeve sipas qendra							
			si qendër	s i	siqendër lokale					
QENDRAKRYESORE										
1	Klinë	5452 63	36357 426	10234 119	7032 82	2	2	1		
SUBQENDRA										
1	Zllakuqan	659 7		4899 57	2333 27	1			1	
2	Gllarevë	2196 25		8126 95	2678 31	1				1
3	Sferkë	2451 28		4388 51	4388 51	1			1	
4	Grabanicë	728 8		6285 73	2910 34	1			1	
QENDRALOKALE										
1	Budisalc	397 4			1091 12	1				1
2	Ujëmirë	544 6			5468 64	1			1	
3	Jashanicë	1786 20			3202 37	1				1
4	Shtupel	778 9			1475 17	1				1
5	Drenoc	442 5			3375 39	1				1

Tab.....Tipet e qendrave me numrin e banorëve për rzonën e mbulimit për shërbime¹⁵

Plani do të fuqizojë komunën për të luajtur rol me aktiv mes paleve për të nxitur zhvillimin e komunës në bashkepunim me pronarët e trojeve për të ofruar mundesi përfitimi për shërbime publike. Plani gjithashtu merr në përgjegjësi të përmiresoj situatën aktuale komunale. PZHK-ja parasheh në disa raste një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor. Gjatë analizës është vërejtur se PZHK-së sidomos pjesës grafike i mungojnë zona që do të pyllëzohen, zhvillimi i pyjeve, shiritat të gjelbër, tampon zonave të gjelbra, rrjetit të levizjës së bicikletave, etj.

Nje grup ekspertesh mjedisi janëpërfshirë për të lehtësuar procesin e VSM dhe për të përgatitur raportin përkatës. Fillimisht hartimi i VSM ka kaluar përmes rishikimit të dokumenteve ekzistues dhe paraqitjes së një liste me kritere mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal të Klinës në zona të ndjeshme mjedisore. VSM po hartohet njëkohësisht me Planin zhvillimor Komunal. Si e tillë VSM po kryhet kur alternativat janë ende të hapura. Po konsideron efektet mjedisore të propozimeve strategjike dhe paraqet elementet mjedisore të qenësishëm që kufizojnë zhvillimin urban, dhe po ndihmon në marrjen e vendimeve për planifikimin zhvillimor komunal në nivel strategjik.

Pjesëmarrja publike është shumë e rëndësishme për hartimin e PZHK-së. Komuna ngriti Grupe punuese që siguruan përfshirjen e ekspertëve të fushës, si edhe Ekipin komunal të planifikimit që mundesoj vëmendjen ndaj gjithë spektrit të shqetësimeve qytetare. Qofte Grupet punuese dhe qofte ai

¹⁵ Draft PZHK –Klinë.

komunal i planifikimit janë mbledhur në disa dhjetëra takime për të shprehur komente, verejtje apo sugjerime për hartimin e një Plani Zhvillimor Komunal sa me perfshires. Përveç këtyre takimeve gjatë procesit të hartimit të Planit, Komuna ofroj mundësinë që publiku i gjerë të shqyrtojë Projekt-Planin për pyetje, verejtje, komente ose sugjerime. Vetëm pas grumbullimit dhe trajtimit të plotë të seciles prej pyetjeve, verejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut komuna do paraqese variantin përfundimtar të Planit Zhvillimor Komunal për miratim në Kuvendin Komunal duke pas parasysh edhe komentet, verejtjet dhe sugjerimet e MMPH-së.

Shkalla që PZHK-ja ndikon në planet e tjera

PZHK-ja vlerësohet të ketë pasur një vështirësi të plotë të planeve të ndryshme të cilat janë zhvilluar në nivel të Kosovës ose Planeve dhe Projekteve të cilat janë bërë më herët në Komunën e Klinës (PZHU). Kurse për zonën urbane kanë ekzistuar plane detajizuese. Të gjitha këto plane janë marrë në shqyrtim dhe vlerësohet se gjendja në terren ka ndryshuar.

Disa nga aspekte kryesore të gjendjes aktuale mjedisore

Të dhënat më poshtë i referohen gjendjes mjedisore të tanishme në komunën e Klinës. Qëllimi kryesor i diskutimit të të dhënave bazë është të identifikojë gjendjen mjedisore në ballafaqim me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të Planit Zhvillimor Komunal të komunës së Klinës. Impaktet potenciale të zhvillimit të PZHK-së mund të vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e Planit nëpërmjet indikatorëve të gjendur/të supozuar sasiore ose cilësore. Esencialisht, gjendja mjedisore e komunës së Klinës karakterizohet nga përshkrimi i receptorve mjedisore, siç kërkohet nga Direktiva e VSM, të përshkruara më poshtë:

- Popullsia dhe Shëndeti publik;
- Fitodiversiteti dhe Zoodiversiteti;
- Zonat e mbrojtura të natyrorës;
- Cilësia e ajrit
- Bezdisjet- zhurma kundërmimi pamjet e pa këndshme;
- Faktorët kilamtikë, ndryshimet klimatike;
- Uji në përgjithësi;
- Toka bujqësore dhe peisazhi;
- Asete materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);
- Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike);
- Trashëgimia natyrore (Zonat dhe monumentet e mbrojtura natyrore).

Popullsia dhe shëndeti publik

Në komunën e Klinës jetojnë rreth 38496 banorë, në qytetin e Klinës jetojnë rreth 5542 banorë¹⁶, ndërsa pjesa tjetër jetojnë në zonat rurale (fshatra). Territori administrativ i komunës është i pozicionuar në lindje të rajonit të Pejës dhe mbulon sipërfaqen prej 308.8km². Dendësia e popullsisë 124.66 b/km², ndërsa dendësia mesatare e popullsisë në shkallë vendi 205 b/km², 3.2% e territorit të shtetit. Popullsia e disa vendbanimeve sidomos ato afër rrugëve vazhdon të rritet me ritme më të larta të rritjeve të cilat ndikon drejt përndrejt në zgjerimin e zonave të banimit drejt zonave me rrezikshmëri mjedisore.

Për shkak të kushteve të jetesës vërehet se familjet e reja, përgjithësisht, tentojnë të vendosen në disa vendbanime si Klina, Peja dhe Prishtinë etj., gjë që kërkon përmirësime të rëndësishme infrastrukturore në to, më shumë energji, ujë, rrugë, shkollë, kopshte, etj.

¹⁶ Agjensioni i Statistikave të Kosovës regjistrimi i popullsisë 2011

Shëndeti

Ndikimet në shëndetin e publik për VSM, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë (komponente mjedisore të tilla si ajëri, uji apo tokë nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit me njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para së gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisore. Dëndësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja e hapsirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, përkeqesimin e parametrave mjedisore të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit.

Ne komunën e Klinës, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF dhe QMF.

Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin

Më poshtë, janë identifikuar dias ndikime që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Ndertimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave te zeza si dhe manaxhimi i mbetjeve.
- Mbrojtja e Vegjetacioneve autoktone;
- Mbrojtja e zonave të llojeve bimore endemike;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;
- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;
- Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore të pellgut;
- Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit;

Veçori natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen

Te pjesa e gjendjes ekzistuese të komunës janë paraqitur mjaft të dhëna për veçrit natyrore dhe karakteristikat tjera natyrore.

Me zgjerimin e disa vendbanimeve janë të njohura edhe disa përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Zhvillime dhe ndërtimet edhe në disa zona sensitivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe gjeologjik. Zhvillimet dhe ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcënuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustron në disa nga shifrat që mundë të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytëzimi i tokës në vitet e më hershme dhe tani. Shumfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të toke bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethe, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një tërsie pejsazhesh e gjelbrimi.

Zonimi i territorit të komunës

Duke u bazuar në tipologjinë e vendbanimeve, popullsitë, infrastrukturën shoqëruuese arkitekturat, gjeomorfologjitë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Klinës me PZHK janë trajtuar si më poshtë:

Zonat e ndërtimit në vendbanime:

• Zonat e zhvilluara me ndërtim:

Me PZHK janë identifikuar dhe trajtuar zonat ku është duke u zhvilluar ndërtimi sot nëpër vendbanime siç shihet edhe nga harta e vendbanimeve në PZHK duke i respektuar disa kriterë si Parashikimet demografike, Dendësia e popullsisë, Zona ekzistuese e ndërtuar, Toka bujqësore

por duke mos përfillur disa nga kriteret siç janë Ndjeshmëria e ujërave nëntokësore, boniteti i tokës, zonat e pasura me trashëgimi arkeologjike.

- **Zonat e pazhvilluara me ndërtim:**

PZHK-ja i ka identifikuar dhe trajtuar duke i destinuar si tokë bujqësore, tokë pyjore zona të mbrojtura natyrore dhe zona tjera të mbrojtura, zona për infrastruktur hidrografike dhe infrastruktur tjetër.

- **Zonat turistike**

PZHK ka identifikuar zonat turistike për të gjithë llojet e turizmit të mundshëm në komunën e Klinës kurse nuk janë të prezantuar në hartën e turizmit.

Zona të mbrojtura

PZHK-ja ka evidentuar gjithashtu zonën ku përfshihen zonat karakteristike me vlera të trashëgimis kulturore - historike, peisazhike, mjedisore e turistike të Komunës. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat çenojnë identitetin e zonës. Objektet ekzistuese të zonës mund të restaurohen vetëm në kushte të cilat i japin institucionet kompetente, duke mos cënuar identitetin e tyre (Mirusha lugina e lumit Klina, dhe disa zona që shpellen të interesit komunal me PZHK).

Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale

Zona industrial planifikohet të jetë lokale, dhe do zhvillohen kryesisht ku tashmë është krijuar një bërthamë e një zone industriale në qytet ose aty ku vërtet ekzistojnë kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio-ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me PZHK dhe duhet propozuar masat mjedisore. Në hartë nuk është e paraqitur kufiri i zonës industriale.

Pyllzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e blerta dhe të pushimit

Komunën e Klinës sikurse në gjitha komunat tjera të Kosovës zhvillimet nuk i kan favorizuar pyjet dhe zhvillimin e tyre, sidomos pyjet e zonave të ulta (Shpërdhit me qarr). Shumë nga zonat e gjelbërta, zonat rekreative natyrore, në shumicën e rasteve vëihen para shkatërrimit total të tyre, si pasojë prerjeve ilegale, djegjeve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës. Hapësira pyjore dhe zonat e shkurreve dhe kullosat janë planifikuar në PZHK. Deri tanishumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund të organizohen pushime vikendi apo diçka të ngjashme.

Esenciale çka PZHK-ja duhet ofruar është sigurimi i korridoreve të gjelbërta që do të zhvillohen të bashkëshoqëruara me ndërtimin e rrugëve të reja dhe atyre ekzistuese, korsive për këmbësorët dhe bicikletat dhe tampon zonave të zhvillimit industriale dhe tjera të ndjeshme, si dhe rritjen e fondit të gjelbër në komunë.

Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik

- PZHK duhet të tregojë çart në hart vendet ku kemi erozion dhe çfarë shkalle të erozionit nëse kemi erozion shumë të fort ose të fort ather të merren rreptsisht masa për parandalimin e tyre, poashtu duhet të tregojë për zonat e vërshimeve dhe masat të cilat duhet të merren kundër vërshimeve.
- Zhvillimi i zonës industriale duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hasirat e banimit duke e precizuar çart në hart (pjesa grafike);
- zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas rivlerësimeve mjedisore;

- Zhvillimi i Pyjeve, hapsirave të gjelbërta, shiritave gjelbrues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan e sidomos në Planet Rregulluese dhe projekte duke vlerësuar raportet e ndërtimit.

Biodiversiteti, Flora dhe Fauna

Biodiversiteti i Komunës së Klinës duhet të mbrohet përmes projekteve dhe planeve promovuese dhe forma tjera të mbrojtjes, poashtu duhet pasur parasush gjat zbatimit të projekteve infrastrukture dhe ndërtimore duhet ruajtur habitatet natyrore të shtazëve dhe bimëve nga zhurma dhe forma tjera të bezdisjes dhe ndotjes. Komuna e Klinës ka një pozitë të mirë gjeografike me një hidrografi të pasur dhe shtrirje mjaft të madhe gjeografike, e cila përfshin zonat mesatarisht të larta dhe zonat e ulëta të terrenit. Në këtë komunë, sa i përket **fitodiversitetit** lidhur me llojet e bimëve këtu kemi mjaft llojllojshmëri të bimëve nga ato barishtore njëvjeqare dheri te ato shumëvjeqare dhe drunore apo brezat e pyjeve. Nga brezi i shpardhit me qarr (*Quercus frainetto* dhe *Quercus cerris* shkon deri te brezi i ahut dhe shkozës. Brezi i pyjeve të shpardhit me qarr dhe bungbut janë brezi më i dëmtuar nga faktori njeri. Ndërkaq në zonat e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqërime mjaft të mëdha dhe të begatshme me lloje. Po ashtu, në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin ruderal përgjat rrugëve dhe vendbanimeve por, edhe barërat e kqia të cilat gjenden në tokat djerrina, në kufi të parcelave dhe në afërsi të gjerdheve.

Zoodiversitetit: Ihtiofauna: peshqit të cilët lajmerohen në këto ujëra janë: bërcaku, ngjala, mustaku, trofta e danubit dhe trofta projesh ne ujërat e Drinit të Bardhë,

Herpetofauna: Amphibiet- ujëtokësorët - bretkocat *Bufo bufo*, *Bufo viridis* *Rana rudibunda*, *Rana esculenta*, Salamandrat. Zvarranikët- breshkat, gjarprinjt dhe picrraku.

Ornitofauna: nga shpezet lajmerohen: kukapikëthi i larmë, bilbili, kukuvajka, thëllënza, fazani, kumrija, krahëthata dhe mullizera. Shpezët sezonale të këtij territori janë gjeraqina, shkurtëza, borsi, gushkuqja, çyqja. etj.

Mamalia – gjitarët janë më të shprehur vjedullat, kunadhja, ketri, ujqit, vidrat dhe kaprojt.

Tipet e Habiteteve

Disa nga habitatet në komunën e Klinës janë të klasifikuara si të mbrojtura në nivel qendror dhe lokal (disa zona të identifikuar me PZHK). Ato klasifikohen si më poshtë:

- Pyjet dhe korie
- zonat e mbrojtura natyrore;
- Ligatinat;
- Lumenjt;
- Kullosat
- Zona e lumit Mirusha .

Çështje mjedisore të lidhura me biodiversitetin, florën e faunën

Ekzistojnë disa çështjesa i përket manaxhimit të biodiversitetit të komunës së Klinës. Çështjet në vijim janë identifikuar për zhvillim të mëtejshëm:

- Ekosistemet ujore (Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Klina, Mirusha dhe Lumi i Istogut) janë të fragmentuara, të degraduara në disa pjesë nga eksploatimi i rërës, nga mbetjet që hudhen nga qytetarët, dhe siç janë, kanë humbur habitate për specie të rëndësishme. Gjendja e tanishme nuk siguron dot nivele të pranueshme të habitateve natyrore;
- Prerja dhe djegja e pyjeve si ekosisteme vjen deri territja e volumeve të ujit sipërfaqësor si pasojë edhe e ndërtimeve dhe deponimeve mbetjeve të ngurta në zonat e vendbanimeve. Kjo

mund të rritë përmytjet duke shkaktuar vërshime dhe erozionin, kështu duke humbur direkte habitatet;

- Masa për të ruajtur biodiversitetin dhe balancin ekologjik në natyrë duhet marrë në konsideratë, në fazat e herëshme, në plane të reja zhvillimi;
- Harmonizimi i planeve rregulloredhe masave duhet koordinuar me njësi të tjera të qeverisë qendrore me qëllim sigurimin e një brezi të gjelbërt rrugve magjistrale dhe rajonale.

Përdorimi i Tokës dhe Peisazhi

Planifikimi i përdorimit të tokës dhe çështje të sigurimit të shërbimeve

Për të vlerësuar tokën si burim natyror i pa rinovueshëm dhe rolin që ka në hapsira banimi fillimisht po japin definicionin dhe funksionet bazë të saj. Toka përcaktohet si pjesa e sipërme e kores tokësore, veçanërisht komplekse, që luan rol të rëndësishëm në mjedis në zhvillimin social dhe ekonomik të cilat janë vitale për jetën. Direktiva kuadër e tokës (BE) identifikon shtatë funksione bazë të saj të cilat janë:

- Prodhimi i biomasës, përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë;
- Mbajtjen, filtrimin dhe transformimin e ushqyesve, substancave dhe ujit;
- Mbajtëse e biodiversitetit;
- Mjedis fizik dhe kulturor për njerëzit dhe aktivitetet humane;
- Burim materiale;
- Si depozitë karboni;
- Arkiv për trashëgiminë gjeologjike dhe arkeologjike.

Disa nga zhvillimet në komunën e Klinës sidomos ndërtimet e pa planifikuara nuk kanë bërë një përdorim efikas dhe të qëndrueshëm të tokës. Shumë nga zhvillimet e paplanifikuara nëpër vendbanime, mund të thuhet se i kanë përkeqësuar problemet e infrastrukturës dhe kanë çuar në degradim mjedisor. Shumë nga kanalizimet e furnizimit me ujë dhe të ujërave të ndotura tashmë gjenden në tokë me pronsi private, për të cilat të drejtat e kalimit dhe përdorimit nuk janë plotësisht të përcaktuara, duke e kufizuar kështu mundësinë e hyrjes për mirëmbajtje.

Poashtu, pa ndonjë plan, apo edhe vlerësim të resurseve, janë aprovuar shumë projekte të reja. Nuk është e qartë se a është bërë vlerësimi i furnizimit të mjaftueshëm me ujë dhe energji i këtyre zhvillimeve të reja.

Infrastrukturën dhe shërbimet për vendbanimet, duhet ti siguroj Komuna. E kombinuar me një kërkesë për infrastruktur dhe mobilizim të resurseve financiare, kushtet mjedisore në komunë vazhdojnë të jenë një problem.

Toka ndërtimore në territorin e komunës merr një rëndësi të posaçme; për efekt të mungesës së fondeve dhe planifikimeve, për gjatë 20 vjetëve të fundit në Kosovë, toka pronë publike është zvogëluar dhe prona private po dominon. Rritet e çmimit të sipërfaqeve të konsideruara si truall kanë qënë të larta. Statuti privat dhe çmimi vështirëson sot komunën e Klinës të gjëjë hapsira për vepra publike. Kjo do të vazhdojë edhe më tutje duke kufizuar shpesh implementimin e PZHK-së në vepra publike (rrugë, lulishte, parqe, etj).

Çështje mjedisore që lidhen me përdorimin e tokës

- Përdorimi i tokës për ndërtim është në rritje dhe raporti ndërtim/sipërfaqe e gjelbërt është i disfavorshem duke krahasuar me normat europiane për etnitete me specifika të njejta në komunën e Klinës kemi shtrirje disperse të vendbanimeve;

- Planifikimi i zonave ndërtimore nuk duhet të prekë sipërfaqe të gjelbërta veç në raste të jashtezakonshme dhe duke i rikompensuar ato;

Duke pasur parasysh keto specifika, ne kapitullin më poshtë paraqiten masa të pershatshme për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra. Për më tepër, paraqiten kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin e ndërtimeve, që përfshijnë kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, kriteret e trashëgimisë kulturore, kriteret peisazhike dhe ato inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Rreziqet natyrore në mjedisin fizik

Me rritjen e ndërtimit dhe degradimit të pyjeve, rreziku i përmytjeve do të rritet shumë.

Kjo gjë përshkruhet mëposhtë në seksionin mbi Menaxhimin e Mbeturinave të lëngshme dhe Ujërave të Shiut.

Adaptimi dhe Zvogëlimi i Rrezikut të Katastrofave, përmirësimi i informacionit dhe reagimi për zbutjen e efekteve të çdo katastrofe natyrore duhet parë me prioritet edhe atë në funksion të:

- Menaxhimit të Rrezikut të katastrofës;
- Forcimit të shërbimeve hidrometeorologjike;
- Caktimit të kodeve të ndërtimit për aktivitetin sizmik;
- Sigurimin e individeve dhe bizneseve nga katastrofat natyrore.

Në tabelën në vijim do të paraqesim zonat në të cilat duhet të merren masa kundër erozionit shumë të fort, erozionit të fortë sipas një klasifikimi të projektit EULUP në Kosovë.

Tab.... Vendet ku duhet të merren masa kundër erozionit

Emir i fshatit	Lloji i erozionit	Hapësira në ha
Këpuz	Shumë i fort	10.27 ha
Këpuz	I Fortë	190,37 ha
Volljak	I Fortë	33.25 ha
Qupevë	Shumë i fort	27.7 ha
Greminik	Shumë i fort	103 ha
Dollovë	I Fortë	17.5 ha
Çeskovë	I Fortë	26.2 ha
Bokshiq	I Fortë	38.5 ha
Dugajevë	I Fortë	8.1 ha
Dërsnik	Shumë i fort	25.3 ha
Klinafc	Shumë i fort	32.1 ha
Gjurgjevik i Madh	I Fortë	13.7 ha
Gjurgjevik i Madh	Shumë i fort	16.6 ha
Gjurgjevik i Madh	Shumë i fort	16.1 ha
Dush	Shumë i fort	16.7 ha
Siqevë	Shumë i fort	43.1 ha
Ujëmir	Shumë i fort	51,78 ha
Ujëmir	I Fortë	39.1 ha
Qabiq	Shumë i fort	41.2 ha
Qabiq	I Fortë	29 ha
Shtupel	I Fortë	23.6 ha
Dranashiq	Shumë i fort	22.8 ha
Bingjë	Shumë i fort	14.4 ha
Jashanicë	Shumë i fort	5.3 ha

Mjedisi i ndërtuar dhe kultura

Sikurse komuna tjera të rajonit të Pejës edhe komuna e Klinës është si komunë administrative jo fort e vjeter e disa nga vendbanimet e saj datojnë që nga lashtësia dhe prezantojnë vlera që janë të mbrojtura për nivelin e Kosovës.

Cilësia e ajrit

Industria e pa zhvilluar ka ndikuar pozitivisht në cilësinë e ajrit, ndërkoh që zhvillime tjera pas luftës në Kosovë si komunikacioni, djegia e pa kontrolluar e mbeturinave, djegiet e biomasës, produkteve bujqësore lirimi i disa gazrave si freoneve, dhe gazrave azotike të cilat po përdoren kohëve të fundit në vend të karburanteve këto ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e ajrit në hapësira të ngushta siç janë fshatrat që ndodhen në luginë ku lëvizjet e masave të ajrit janë të vogla. Zhvillimet ekonomike dhe sociale pas luftës veçanërisht rritja e numrit të automjeteve kur dihet se pjesa më e madhe e tyre janë të stërvjetuara të viteve të 80-ta, poashtu edhe veprimtarive ndërtuese kanë shkaktuar një ndotje të ajrit në Komunë. Në mënyrë të përbledhur po rendisim disa subfaktorë të cilat kanë ndikim në cilësinë e ajrit në komunën e Klinës:

- Komunikacioni hekurudhorë;
- Rritja e lartë dhe përdorimi i shpeshtë i makinave private;
- Shumica e këtyre automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje me Euro I apo II;
- Edhe pse të vjetër gjendja teknike e tyre jo e mirë, duke liruaz gazra dyfish më shumë se normal;
- Gati të gjitha objektet përdorin ngrohje individuale me dru dhe forma tjera të djegies;
- Një pjesë e madhe e tyre punojnë me naftë dhe me plin;
- Nga të gjitha rrugët që kalojnë nëpër territor të komunës së Klinës, shumica janë të asfaltuar;
- Djegiet e mbeturinave në deponi të egra;
- Djegiet e pyjeve dhe mbetjeve të biomasës.

Një tjetër problem që lidhet me cilësinë e ajrit është edhe cilësia e karburanteve që përdorin automjetet. Shumë gjeneratorë me naftë që përdoren për të kompensuar ndërprerjet e energjisë janë gjithashtu kontribues në këtë cilësi të dobët të ajrit, mbasi punojnë me naftë të cilësisë së dobët. Megjithatë lidhur me këta të fundit, ndikimi i tyre në cilësinë e ajrit të komunës së Klinës është minimal.

Harta në figurën më poshtë tregon zonat kryesore të ndotjes së ajrit në Klinë. Ato janë në rrugët kryesore ku ka përqendrim të lartë të ndotjes nga automjetet dhe zonat tjera të ndotjes. Ndërkaq në tabelën më poshtë po paraqesim vendet në të cilat duhet të merren masa për mbrojtje të mjedisit.


Tab.... Vendet në të cilat duhet të merrën masa ndaj ndikimeve të komunikacionit në mjedis

Fshatrat	Lloji i Kominikacionit/rrugorë apo hekurudhorë.	Ndikimi në mjedis	Vendet ku duhet merren masa të shprehura në gjatësi
Gllarevë	Automobilistik Magjistranja Pejë-Prishtinë	Ndotje, zhurmë	2185 m
Dollcë	Automobilistik Magjistranja Pejë-Prishtinë	Ndotje, zhurmë	520 m
Gremnik	Automobilistik Magjistranja Pejë-Prishtinë	Ndotje, zhurmë	300 m
Zajm	Automobilistik Magjistranja Pejë-Prishtinë	Ndotje, zhurmë	2000 m
Drenoc	Automobilistik Magjistranja Pejë-Prishtinë	Ndotje, zhurmë	1900 m
Petriq i Poshtëm	Automobilistik Magjistranja Pejë-Prishtinë	Ndotje, zhurmë	1220 m
Petriq i Epërm	Automobilistik Magjistranja Pejë-Prishtinë	Ndotje, zhurmë	955 m
Dollc	Automobilistik Regjionalja Klinë-Istog	Ndotje, zhurmë	850 m
Dresnik	Automobilistik Regjionalja Klinë-Istog	Ndotje, zhurmë	1680 m
Klinë	Automobilistik Regjionalja Klinë-Istog	Ndotje, zhurmë	2700 m
Zllakuqan	Automobilistik Regjionalja Klinë-Istog	Ndotje, zhurmë	2270 m
Berkovë	Automobilistik Regjionalja Klinë-Istog	Ndotje, zhurmë	1600 m
Klinë	Automobilistik Regjionalja Klinë-Skënderaj	Ndotje, zhurmë	1300 m
Klinofc	Automobilistik Regjionalja Klinë-Skënderaj	Ndotje, zhurmë	1670 m
Shtupel	Automobilistik Regjionalja Klinë-Skënderaj	Ndotje, zhurmë	570 m
Jashanicë	Automobilistik Regjionalja Klinë-Skënderaj	Ndotje, zhurmë	1420 m
Qupevë	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	600 m
Gremnik	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	780 m
Dollc, Dresnik dhe Klinë	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	6700 m
Dushë	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	1200 m
Ujëmir	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	1800 m
Videjë	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	2900 m
Jagodë	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	930 m
Krushevë	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	230 m
Budisalcë	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	1000 m
Stupë	Hekurudhor	Ndotje, zhurmë dhe vibracione	720 m

Rrezatimi jonizues dhe jojonizues

Rezatiimi në përgjithsi nuk është trajtuar fare, ndërko që është fush mjaft komplekse dhe që duhet të trajtohet gjatë hartimit të planeve në përgjithësi. Në komunën e klinës janë të identifikuara dy vende ku është goditur me uranium të varfëruar në luftën e fundit në Kosovë. Nëri vend është afërsi të fshatit Qupevë dhe njëri vend ku është goditur me uranium të varfëruar (UV) është në fshatin Bërkov. Në te dya këto vende ku është goditur me UV me PZHK duhet të tregohen masat të cilat duhet merren në të ardhmen për rehabilitimin e këtyre zonave. Dihet se rrezet UV kanë ndikim të madh në shëndetin e popullatës duke ndikuar në gjitha habitatet ujore, toksore dhe ajrore. Në hartën më poshtë janë të dhanuna pikat ku është goditur me Uranium të varfëruar.


Zonat të cilat janë nën ndikim të ndotjes nga komunikacioni



Harta..... Zonat të cilat janë nën ndikim të ndotjes së ajrit nga ndotja.

Zhurma dhe Kundërmimi

Një tjetër problem mjedisor më të cilin po ballafaqohet gjithnjë e më shumë Komuna e Klinës është zhurma duke e pas parasysh se këtu gjenden koncentrim i vendbanimeve dhe dendësi e konsiderueshme e banimit. Komuna e Klinës ka një rrjet të dendur rrugor dhe hekurudhor. Me PZHK, janë trajtuar disa nga masat mjedisore për amortizimin e zhurmës. Për gjat rrugëve nacionale, hekurudhave dhe rrugëve rajonale duhet të parashihen masa mjedisore kundër zhurmës, siç janë barrierat fizike nga dheu, zona të gjelberta me pyllëzim dhe pahi të plastifikuara në vendet ku janë më të nsjeshme (si shkolla dhe hapësira tjera publike dhe banuese), por për shkak të implikimeve financiare disa nga këto masa mund të mos zbatohen ose mund të mos implementohen në lokacione të caktuara. Komuna e Klinës këtu duhet të jetë vigjilente dhe të jetë e kyqur në kontrollin e ndërtimit të rrugëve.



Harta... **Zonat të cilat janë nën ndikim të zhurmës.**

Përpos këtyre akseve kemi edhe disa pika të ndotjes nëpër vendbanime. Megjithatë zhurma është në të gjitha rastet përtej vlerave limit që percakton Udhezimin “Per nivelet kufi te zhurmave në mjedise te caktuara” dhe Limitet e Pergjitheshme për Nivelin e Zhurmave të OBSH. Një tjetër dukuri për tu vënë në dukje është niveli konstatnt i zhurmës gjat 24 orëve në zonen e bllokut e cila është njëherësh edhe zonë residenciale ku limiti i nivelit të zhurmës në orët e natës nuk duhet të kalojë 45 dBA, ndaj vlerave mbi 60 dBA. Sa i përket kundërmimit si aspekt tjetër i bezdisjes në komunën e Klinës vendet në të cilat kemi kundërmim janë deponit ilegale sidomos ato afër lumenjve për shkak të lagështisë të cilat sjellin në vazhdimësi bezdisje për qytetarët që jetojnë në ato zona. Vend shkarkimet e kanalizimeve të fshatrave dhe vendshkarkimet individuale të kanalizimit të ujërave të zeza janë poashtu burim i kundërmimit, bezdisjes dhe sëmundjeve për qytetarët dhe kalimtarët. Komuna duhet të eliminojë me prioritet deponit ilegale rreth lumenjve dhe të ndërtoj impiante për pastrim të ujërave të zeza siç është parapar edhe me PZHK.

Burimet ujore dhe furnizimi me ujë

Komuna e Klinës ka burime të mjaftueshme ujore për t’iu përgjigjur kërkesave aktuale dhe në perspektive. Aktualisht në gjithë komunën mungon furnizimi me ujë të pijes edhe për kundër faktit se ka burime të mjaftueshme ujore. Komuna furnizohet nga disa burime uji. Një pjesë e sistemit të furnizimit me ujë është i vjetër dhe punon nën kapacitetin e projektuar, ndërkohë që ka dhe shumë humbje në rrjet, nuk disponohet informacion i plotë i lidhjeve ilegale për përdorim shtëpiak dhe ujti. Ka të dhëna që në disa puse të cekët, uji nëntokësor është i ndotur. Gjithësesi shifra e humbjeve mendohet të jetë e lartë.

Monitorimi i cilësisë së ujit në lumenjtë kryhet nga disa institucione MMPH,AKMM dhe institucione tjera. Cilesia e ujit të pishem, përfshirë aspektin bakterologjik monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë, përmes Drejtorive të Shëndetësisë.

Ndërmarrja regionale e Ujësjellësit është gjithashtu përgjegjëse edhe për furnizimin me ujë të fshatrave të Klinës. Në këto fshatra vetëm një pjesë e banoreve kanë kontratë me Ndërmarrjen kurse disa të tjerë shfrytëzojnë burime individuale. Kjo ndodh kryesisht për arsye se:

- rrjeti nuk e furnizon të gjitha vendbanimet, shumë shtëpi kanë sistem privat të furnizimit me ujë me puse private, ose u mungon furnizimi me ujë;
- përdoruesit furnizohen, por me lidhje ilegale, shpesh ngaqë ndërtimi i shtëpisë është bërë në mënyrë informale;
- sistemi i furnizimit me ujë është i vjetër.

Për sa kohë furnizimi me ujë i Klinës vazhdon të jetë me ndërprerje, do të vazhdojë të jetë prezent rreziku për shëndetin për shkak të ndotjes kryesisht bakteriale të ujit. Klorifikimi kryhet në impiantin e trajtimit të ujit ose depozitat e ujit të pishem dhe në pergjithësi uji karakterizohet nga teprike klori si mase preventive për të parandaluar ndotjen bakteriale. Ka patur raste, sidomos në stinen e nxhetë, të sëmundjeve gastro-enterike, por mungojnë evidencat që të mund të percaktojnë lidhjen ndërmjet ujit të ndotur dhe sëmundjes.

Çështje mjedisore që lidhen me ujin e pijshëm

- Ka raste kur cilësia e ujit kontaminohet kryesisht nga ndotjet që pëson në linjat e transmetimit (ndotja nga ujrat e zeza, për shkak të intersektimeve të shumta të tubacioneve të ujit të pishem me ato të ujërave të zeza);
- Sistemi i tubacioneve me materiale kancerogjene;
- Përdorimi për qëllime të tjera veç përdorimit familjar, është i madh duke ulur sasinë e nevojshme për popullsinë;
- Burimet ujore nëntokësore, sidomos ato deri në 20 m thellësi janë të rrezikuara nga ndotja sipërfqësore për shkak të përshkueshmërisë së lartë të shtresave mbrojtëse.

Në komunën e klinë ekzistojnë disa zona të ndjeshme të ujërave nëntokësore të cilat duhet mbrojtur në mënyrë rigoroze. Në tabelën më poshtë janë të paraqitura si zona të ndjeshme të ujërave nëntokësore në secilin fshat dhe janë të paraqitura në hektar.

Tab.....Zonat e ndjeshme të ujërave nëntokësore të cilat duhet të mbrohen në mënyr rigoroze

Fshatrat	Hapësira në ha
Këpuzë	93 ha
Vëlljakë	49 ha
Qupevë	50 ha
Dollovë	110 ha
Gremnik	177 ha
Grabanicë	218 ha
Zajm	236 ha
Dollcë	111 ha
Drenoc	88 ha
Petriq i Poshtëm	98 ha
Petriq i Epërm	172 ha
Dresnik	376 ha
Deiq	61 ha
Klinë	140 ha
Videjë	309 ha
Jagodë	88 ha
Krushevë	108 ha
Nagllavë	11 ha
Budisalcë	126 ha
Stupë	201 ha
Rudicë	117 ha
Berkovë	64 ha
Jashanicë	20 ha
Klinafc	21 ha
Dushë	60 ha
Gjurgjevik i Madh	23 ha
Siqevë	73 ha
Ujëmir	89 ha

Grumbullimi i mbetjeve të ngurta

- PZHK përmend riciklimin, ndërkaq nuk tregon një lokacion të sakt ku do të bëhet grumbullimi i mbeturinave selektimi dhe proceset tjera;
- Në Plan parashihet përfshirja e të gjitha vendbanimeve në kuadër të rrjetit të infrastrukturës së grumbullimit dhe menagjimit të mbeturinave të ngurta;
- Mbyllja e deponive ilegale të mbeturinave të cilat gati në të gjitha rastet janë deponi spontane dhe të paligjshme dhe ndodhen kryesisht në përfiferi të vendbanimeve rurale.

Menaxhimi i mbetjeve të lëngëta dhe kullimi i ujërave të shirave

Shumë nga vendbanimet në Komunën e Klinës nuk kanë menaxhim efektiv të ujërave të zeza. Janë ndërtime të paligjshme që derdhen drejt e në lumenj, të cilët shpesh janë jasht standardit dhe rrjedhin, duke shkaktuar ndotjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nentokesore.

Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura përbën ndoshta rrezikun të madh mjedisor për Klinën dhe sigurisht shkakton ndotje të madhe.

Duhet vënë në dukje se MMPH ka parapa impiant regjional për trajtimin e ujërave të zeza konfiguracioni i terrenit të Klinës paraqet përpasi në këtë funksion.

Furnizimi me energji

Furnizimi me energji bëhet nga KEDS-i. Ndërprerjet e vazhduara të energjisë elektrike kane qenë shqetësuese vite më parë edhe se me trend të zvogëluar por prapë paraqesin një shqetsim. Kjo sillte dhe vazhdon të siejell si pasojë përdorimin e gjeneratorëve me naftë, që rendonte ndotjen e ajrit dhe që po vazhdon kohë pas kohe.

Aktivitetet ekonomike dhe sociale

Aktualisht nga analiza të kryera nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për komunën e Klinës dhe Grupi punues për zhvillim ekonomik u konsiderua se fusha kryesore e cila mundë të zvogëloj numrin e migrameve nga Klina por edhe krijoj kushte për të punuar dhe jetuar është planifikimi i zonave të zhvillimit ekonomik të shprehura në PZHK me harten e turizmit, bujqësisë transportit, pasurive minerare dhe aspekteve e potencialeve tjera të zhvillimit.

Disa mundësi të planifikuara të zhvillimit ekonomik janë prezantuar në PZHK.

Nuk ka ndonjë studim të drejtpërdrejtë që të lidhë kushtet e mjedisit me aktivitetin ekonomik të Klinës. Megjithatë, nuk rezulton që aktualisht aktivitetet industriale të cilat janë kryesisht të karakterit nxierrës të mineraleve me intensitet të vllim të ulët, nxierrje e zhavorit, prodhim të asfaltit, betonit, parafabrikateve etj të kenë krijuar çrregullim mjedisor.

Avansimi drejt stabilizimit në furnizimin me energji elektrike gjithashtu, ka minimizuar edhe përdorimin e gjeneratorëve industrial, të cilët emetonin sasi të konsiderueshme gaze ndotëse, duke ju shtuar shkarkimeve të po se njejtës natyre nga transporti.

Legjislacioni aktual për investitorët vendas dhe të huaj, në veçanti ai mjedisor, që në përgjithësi është i përafshir me atë të BE, parashikojnë të gjitha procedurat dhe masat për të siguruar që investimet për zhvillimin social ekonomik në komunën e Klinës ashtu si dhe në gjithë vendin, të mos dëmtojnë apo dëmtojnë mjedisin.

PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE

PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QE KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të PZHK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore qëkufizojnë zhvillimin komunal në vendbanime të ndryshme të komunës dhe pjesë të caktuara të qytetit.

Parimet e përgjithshme për planifikim hapësinor

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbledhen në dhjetë pika si mëposhtje:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejzazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve dhe komunikimin e habitateve mes veti;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe pergatitjen e sheshit;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion; dhe
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Ne kuader të hartimit të PZHK-së parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme (siç janë paraqitur edhe në këtë material):

- Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar;
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës;
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve – akses i nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;
- Rehabilitimi i tokës bujqësore;
- Rihvillimi i pyjeve kuzistuese, pyllzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore – historike dhe natyrore;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

Objektiva strategjike

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

- Zhvillimi i mëtijshëm i vlerave, ku të gjithë aktorët e kryera të drejtën e tyre për të ditur, për t'u dëgjuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën dhe tendencat e tij. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;
- Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, eliminimin e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të

standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;

- Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj);
- Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilesisë së jetes në komunë (rritja e sigurisë, shtim i mundësive për menyre aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, PZHK-ja duhet të zbatojë disa parime dhe modele zhvillimi të pranuar gjerësisht, si psh. Komuna e Klinës komunë policentrike, ku qytetari gjen shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevojë të udhetojë për të siguruar shërbimet veç në qendërën administrative.

PZHK-ja parashikon zhvillimin e Komunës si një e tërë me vendbanime, lagjet, e deri tek zonat e vogla të banimit. Në këtë fazë, duke qenë Plan i Zhvillimit Komunal, do jepen kufijt, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standartet e parashikuara për tërë komunën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim, dhe më pas puna do vijojë me Planin Rregullues Urban të detajojnë zhvillimin për çdo zonë banimi. Planin do përfshijë konceptin e formules së menaxhimit të pronës në menyre adekuate pa dallime të pronarve gjatë destinimeve në zonat ndërtimi gjelbrim etj. Sfidues është fakti nga se në PZHK nuk vërehen sakt të specifikuar si zona zhvillimit e reja të infrastrukturës, zonat industriale, etj., të cilat do të analizohen ndikimi i tyre në korridoret e qarkullimit të shtazëve ose a janë marrë masa të duhura për qarkullim natyror të shtazëve dhe llojeve bimë nga një habitat në tjetrin, pyllzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve, etj. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden vetëm në pjesën strategjike. Një sfidë e vecantë mbetet zbatimi në praktike të këtyre synimeve të PZHK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shiritat të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisorë të komunës.

Gjithashtu plani synon të integrojë dhe përmirësojë situatën aktuale komunale, si psh. zgjerimi i vendbanimeve në drejtimin më të favorshëm në kuptimin e shtrirjes në tokë më plotësisht të dobëtdhe me përdorim të përzier.

Një tjetër aspekt mjedisor i Planit është rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisorë (duke mos specifikuar sakt lokacionet e pikave të nxehta mjedisorë por kjo është trajtuar si problem), ndermarrje që krijon mundësi për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, për çlodhje dhe arëtim.

Në mënyrë të përmblendhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin e Planit mund të përmblidhen si mëposhte:


1. Pakesimi i sasisë së mbetjeve dhe menaxhimi i integruar i tyre;
2. Krijimi i njëkomune të qëndrueshme dhe të shëndetshme;
3. Identifikimi dhe krijimi i habitatve të reja, dhe korridoreve të gjelbra;
4. Përmirësimi i cilesisë së ajrit, përfshirë reduktimin e zhurmave;
5. Kursimi i energjisë dhe paksimi i emisioneve të gazeve sërë;
6. Cilesia e ujërave sipërfaqësore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives në kuadër për Ujin të BE-së;
7. Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me bicikleta;
8. Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë arkeologjike dhe arkitekturore;
9. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;

10. Mbrojtia e mjedisit natyror në pyjet dhe malet;
11. Riperdorimi i disa tokave të ndotura në vend të tokave të reja.

Veprime operacionale në mbështetje të objektivave strategjike

Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbërta në Klinë:

1. Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura të njohura në komunën e Klinës siç janë:
Zona e lumit Mirusha, lugina e lumit Klina;
2. Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për reth vendbanimeve;
3. Krijimi i koridoreve të reja ekologjike dhe zonave të Klinës zgjatimi dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në koridorin përgjatë lumenjve;
4. Krijimi i lulishteve dhe kopshteve në Klinë;
5. Kthimi i zonave të degraduara në sipërfaqe të gjelbra;
6. Gjëlberimi i kopshteve të shtëpive private;
7. Gjëlberimi me pemë dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
8. Ngritja e barrierave të dendura me gjëlberim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllime të shumëfishtë (ritje gjëlberimi, përmirësim i cilësisë së ajrit përmes filtrimit të pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore).



Harta nr. shfrytëzimi i tokës¹⁷

¹⁷ Draft PZHK –Klinë.

Veprime operationale për përmirësimin e sistemit të transportit dhe shtimit tëpërmbajtjeve:

1. Ndërtimi i një rrjeti rrugor që lidhin Klinën me rajonin dhe fshatrat mes veti;
2. Përmirësim i gjendjes së rrugeve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundësisë;
3. Krijim i rrjetit të plote rrugor nëvendbanmet e mëdha me përmbajtje edhe për biciklistet dhe kembesoret;
4. Përmirësim i sistemit, orareve dhe cilesise se autobuzeve;
5. Përmirësimi i projektimit të rrugëve me parashikimin e trotuareve të plota dhe shiritave/korsive për biciklist sipas standarteve europiane të rrugeve;

Kriteret mjedisore qe kufizojne zhvillimin komunal

Më poshtë paraqiten disa kriteret mjedisore që duhet të kufizojne zhvillimin komunal, të grupuara në kater kategori kryesore, përkatesisht (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, (2) kriteret të trashëgimisë kulturore, (3) kriteret peisazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Kriteret të forta mjedisore-shëndetësore

Këto kategori kriteresh përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (I) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. zonat e mbrojtura të natyrës), (II) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (III) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike).

(I) Zonat me vlera të veçanta mjedisore përfshijnë:

- Parku natyror “Mirusha” Kanioni, ujëvaret dhe peizazhet specifike, një fenomen natyror me rëndësi të jashtëzakonshme;
- Gryka e lumit Klina, Klinë – monument i natyrës me vlera gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike;
- Zonat përgjat lumenjve dhe disa rrjedheve tjera të identifikuar si biokoridore kryesore dhe bikoridore sekondare;
- Kaptazhat e burimeve ujore në të gjithë komunën;
- Mbrojtja e burimeve të ujërave minerale nëDresnik dhe Rudicë;

Nuk lejohen ndërtimet në zonat e mësipërme që bartin vlera të veçanta mjedisore.

(II) Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

- Shterit e lumenjve dhe pjesët buferike rreth tyre
- Basenet nentokësore ujëmbajtëse;
- Zonat me pjerresi më të madhe së 15 apo 20%.

Nuk lejohen ndertimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmbytjeve (qofte dhe shumë të rralla), mund të shkaktojnë erosion të brigjeve, si dhe të cenojnë rregjimin hidrologjik të sistemit ujqor.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndertimet ne zonat me pjerresi të madhe pasi në mjedis argjilor këto ndërtime mund të shkaktojnë (ose përkeqesojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Në këtë fazë të Planit Zhvillimor Komunal është vështirë të përcaktohen me detaje këto zona, por gjate hartimit të këtij plani është punuar një planë me pjerrëtesi dhe gjatë zhvillimeve të ardhëshme mundë të superpunohet me informata tjera dhe të shfrytëzohet si bazë për Plane Rregulluese dhe projekte tjera.

(III) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike) përfshijnë:

- Deponia e e egra përgjat lumenjve dhe kanalizimet që derdhen drejt për drejt në lumenj;
- Vendet e goditura me uranium të varfëruar
- Thertore;

- Ndërmarrjetë riparimit të automjeteve;
- Deponit e veturave “varrezat e veturave”.

Këto zona duhet të jenë objekte të studimeve për vlersimin e situates mjedisore mbi bazën e të cilit do te mund të gjykohet mbi nivelin e ndotjës së ujit dhe tokës dhe masat eventuale që duhen ndërmarrë për rehabilitim.


Kritere të trashëgimisw kulturore

Komuna e Klinës ka objekte të trashëgimise kulturore që duhen ruajtur për vlerat e tyre kulturoredhe potencialin turistik në të cilat nuk duhet të lejohet zhvillimi i pakontrolluar.

Vlerat e trashëgimisë kulturore duhen të konsiderohen rast pas rasti me qëllim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin eqendrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor.

Lista e monumenteve te kultures do duhet rishikuar dhe lehtësuar ndjeshem. Disa prej monumenteve te kultures jane cenuar, tjetersuar apo zhdukur. Disa prej monumenteve kanë qenw shpallur pwr motive qartesisht politike dhe lista duhet avancuar.

Ka disa zona tradicionale me vlere konservimi qw mund të mbrohen. Duke pasur vlera të ndërtimit tradicional, këto zonaturistike duhet ruajtur me karakter të veçant.



Harta nrTrashëgimia kulturore¹⁸

¹⁸ Draft PZHK –Klinë.

Kriteret peisazhike

Kjo komunë ka vlera të larta pejsazhike të llojeve të ndryshme si peizazhe që krijojnë pyjet dhe Malet që shtrihen nëjug parku “Mirusha”, livadhet dhe fushat e mbjellura përgjat luginave të lumenjve. Kriteret peisazhike janë vështirë për tu përcaktuar, pasi duhen konsideruar rast pas rasti dhe duhen caktuar në bashkepunim dhe pajtueshmeri me institucionet tjera.

Zona me vlera të larta peisazhike në të cilat nuk duhet të lejohet ndërtimi përfshijnë:

- Lumi Drini Bardh në pjesen më të madhe të segmentit që përshkon i pasur me peizazhe atraktive;
- Peisazhet në Parkun Mirusha;
- Peisazhe malore dhe kodrinoro-malore;
- Zonat për rreth monumentve të natyrës

Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për t’i mbrojtur sa më mirë, intervenimet e njeriut në pikat skenike-atraktive, duhet të minimizohen. Posaçërisht, në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit. Shkaktarët kryesorë të degradimit të peisazhit janë minierat sipërfaqësore (gurthyesit), djegja e pyjeve dhe prerja e pakontrolluar e tyre.

Duke pasur parasysh se Ligji i Planifikimit ngarkon komunat me përgatitjen e Planeve Hapesinore, ndërkohë që Klina edhe se ka përgatit këtë planë duhet që të gjejë mirekuptim dhe bashkepunim me Institucionet tjera kompetente dhe akterët tjer për nevojën e mos-lejimit të ndertimeve në keto zona, qofte duke e sanksionuar këtë edhe me akt-normativ.

**NDIKIMET E MUNDSHME
MJEDISORE DHE MASAT
PËR ZBUTJEN E TYRE**

Plani Zhvillimor Komunal i Klinës dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet Mjedisore

PZHK-ja është rezultat i evidentimit, vlerësimit, dhe prioritizimit të nevojave strategjike zhvillimore socio-economike dhe mjedisore të Komunës së Klinës dhe popullatës së saj nga ana e Grupit hartues të Planit Zhvillimor Komunal. PZHK ka si qëllim transpozimin dhe sendërtimin e Vizionit, të këtyre objektivave dhe prioriteteve strategjike në një sistem planifikimi zhvillimor komunal. Në një proces të tillë të rëndësishëm, ky itinerar do të mbështetet nga hartimi i planeve tjera të vendbanimeve dhe zonave ndërtimore të niveleve më të ulta dhe kodeve me instrumente të veçanta zhvillimi hapësinor, sipas gjithë komponentëve të vet: ekonomikë, socialë, mjedisorë dhe organizativ. Këta instrumente përbëjnë një ndërthurje të programeve të veprimit me nismat investuese, me qëllim orientimin e zhvillimit komunal në zonën e përfshirë në studim.

Planet dhe projektet Sektoriale që hartohen edhe si rezultat i këtij Plani duhet të bëjnë ose të parashikojë të përfshijë vlerësime të kostove dhe të identifikojë ose përfshijë identifikimin e masave të nevojshme që duhen ndërmarrë për implementimin e këtyre propozimeve. Propozimet për zhvillimin zonave, rrugëve etj, përfshihen si në propozimet për përdorimin e tokës, ashtu edhe për ndarjen në faza, pasi duhet që të ruhen apo të gjenden sipërfaqe toke për zhvillimin e zonave, ndërtimin e rrugëve etj, për sa kohë që mundësia e aksesit shihet si mekanizmi kryesor që drejton zhvillimin.

Një qështje tjetër që PZHK trajton janë Parku “Mirusha” dhe lugina e lumit Klina, si dhe tekstualisht janë marrë disa masa për mbrojtjen e këtyre zonave me rëndësi të veçant. Si rezultat, PZHK do të shërbejë edhe si një proces i cili mundëson adresimin e shumë prej problemeve mjedisore sociale, ekonomike dhe organizative të cilat kërkojnë zgjidhje të duhur. Kryesisht duhen investime në infrastrukturë dhe përmirësim i menaxhimit komunal me qëllim që tu jepet përgjigje shumë prej problemeve mjedisore të hapësirës komunale të marrë në studim, ndërsa procesi i planifikimit të zhvillimit të zonave dhe shfrytëzimit të tokës duhet zbatuar sipas këtij Plani, me qëllim që të parandalohet shtrirja e mëtejshme nëpër zonat bujqësore dhe zonat me vlera tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Kjo nevojë për planifikim dhe menaxhim në nivel vendbanimesh të shumta bashkërendimi dhe veprimi në mes tyre është identifikuar si çështje e rëndësishme edhe në raportet e PZHK-së.

Konsiderata mjedisore në hartimin dhe përpunimin e Planit

Plani është punuar duke pasur në konsiderat deri diku edhe vlerësimin mjedisor në çdo fazë të zhvillimit të tij. Megjithatë nuk është qëllim kryesor për PZHK-në, outputet e fazës së parë të studimit të PZHK-së (faza e profilit komunal) përmbajnë të dhëna dhe komente mbi gjendjen dhe problemet e mjedisit në Klinë. Gjatë fazave të zhvillimit të PZHK-së merren në konsideratë çështje mjedisore apo të ofrimit të shërbimeve dhe diskutojnë gjendjen dhe shkakun e problemeve mjedisore në Komunë. Në fazën e profilit mungojnë informatat mbi biodiversitetin dhe gjendjen tijë, mungon gjendja e menaxhimit të mbeturinave, dhe vendet në ndikim nga zhurma, kundërmimi dhe rrezatimi.

Ndërkaq zhvillimet e planifikuara të cilat kanë ndikim në mjedis janë marrë në konsiderat duke i ruajtur të disa nga komponentet mjedisore në aspektin strategjik të zhvillimit të komunës. janë ruajtur ekosistemet të cilat kanë një rëndësi të veçant për Komunën dhe për Kosovën, janë marrë në konsiderat ruajtja e zonave të mbrojtura.

Analiza e plotë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të PZHK-së

Masat të cilat janë marrë për mbrojtje të mjedisit gjat planifikimit nuk do të kenë efekte negative ekonomike apo shëndetësore dhe mjedisore. Për këtë arsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikëpamja sasiore shkalla e ndikimit që do të ketë Plani mbi mjedisin apo shëndetin. Megjithatë, prirjet e këtij ndikimi, të cilat janë edhe objekt i VSM, janë të parashikueshme. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor të Planit, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky Plan. Tabela e mëposhtme shërben si një listë e kontrollit të kriterëve mjedisore sipas të cilave është bërë vlerësimi i këtij Plani. Kjo listë tregon nëse PZHK-ja e ka marrë në konsideratë problemin, e po të jetë kështu, nëse i ka dhënë përgjigje. Kolona e fundit shpjegon përmes shenjave si më poshte:

- * = Ka përgjigje të plotë për problemin;
- += Ka nevojë për masa të mëtejme;
- - = Nuk është trajtuar, duhet të trajtohet me PZHK.

Tabela nr. Konsiderata Mjedisore dhe Shëndetësore të PZHK-së

Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në PZHK ?	Si është trajtuar problemi në PZHK ?	Treguesi
1. Përfshirja e konsideratave mjedisore	Po	Përfshihen në seksionet e mëposhtme.	+
2. Përfshirja e konsideratave shëndetsore	Po	Përkshkruhen në seksionet e mëposhtme.	+
3. Marrja parasysh e objektivave ndërkombëtarë, kombëtarë dhe lokalë për mjedisin dhe shëndetin gjatë formulimit të PZHK-së	Po	Përkshkruhen në seksionet e mëposhtme.	*
4. Përfshirja në sintezë e Konsideratave Mjedisore	Po	Janë përfshirë në PZHK.	*
5. Konsideratat mjedisore në Opcione	Po	Kjo është bërë si pjesë e diskutimeve profesionale gjat studimit të konceptit.	*
6. Koncepti i Planifikimit të PZHK-së			
a. Mbështetje për zhvillimin policeentrik me infrastrukturë të zhvilluar të Klinës	Po	Propozimi ndjek në mënyrë pragmatike prirjet ekzistuese dhe ato strategjike të zhvillimit komunal dhe socialo ekonomik të Klinës. Problemi është që kjo rritje të bëhet mbi bazën e kriterëve të forta mjedisore, dhe të mos shtrihet në tokat bujqësore, pyjet përreth, hapsirat ujore dhe me potencial vërshimi si dhe jo në afërsi të zonave të mbrojtura.	+
b. Afirmon rolin e Klinës në nivel të Kosovës, dhe në nivel ndërkombëtar krahas ofrimit të mundësive të turistike që ofron komuna me parkun Mirusha dhe Luginën e Lumit Klina	Po	Orienton Komunën e Klinës në qender dhe si pikë fokale për të gjitha anet e vendit në kuptimin e zhvillimit të turizmit dhe fuqizimit të trashëgimisë së Kosovës me vlerat e trashëgimis natyrore dhe kulturore.	+

d. Përforcimi i kapacitetit të Komunës për të rritur rolin e migrimit dhe për t'u siguruar banorëve të rinjë mundësi punësimi.	Po	Kjo propozohet të bëhet nëpërmjet zgjerimit në hapësirë në vendbanimet që kanë trende rritje dhe ofrimit të kushteve edhe në vendbanime tjera.	*
e. Integrimi i zonave rurale në komunë dhe ulja e shkallës së përjashtimit ekonomik dhe social të banorëve të tyre.	Po	Është marr në konsideratë që në fazën e nismës së hartimit të PZHK-së.	+
f. Fuqizimi dhe zgjerimi i vendbanimeve brenda kufinjve ndërtimor të planifikuar	Po	Ky koncept ka si qëllim të ndihmojë zhvillimin dhe rigjenerimin e vendbanimeve.	+
g. Harmonizimi dhe barazpeshimi i zhvillimve nëpër nënqendra komunale.	Po	Ky propozim ka si qëllim zhvillimin e nënqendrave të tjera për të ulur stresin në një zonë qendrore. Si i tillë, ai propozon ndërtimin e një serie funksionesh nëpër këto nënqendra.	+
i. Të gjitha potencialet ekonomike janë vë në shërbim të zhvillimit të komunës, duke vu theksin në mundësit zhvillimore në zonat ekonomike të qytetit për biznset e vogla, tëdhe mesme.	Po	Vizion i ri ka për objektiv të gjejë mundësi që zonat e njohura ekonomike dhe turistike në komun të mund të shfrytëzohen racionalisht dhe të ofrohen si një paket turistike shumë atraktive.	*
j. Ruajtja e shtretërve dhe rrjetit të lumenjëve në tërësi (me theks të veçant lumi Drini i Bardh dhe lumit Klina, etj).	Po	Ky koncept dhe kjo ndërhyrje ka për objektiv mbrojtjen e disa zonave ujore brenda hapësirës së Klinës.	+
k. Ruajtja dhe menaxhimi i baseneve nëntokësore të ujërave të cilat ndodhen kryesisht në zonë të Dukagjinit	Po	Problematika është trajtuar në pjesën e analizave të gjendjes ekzistuese, është trajtuar edhe në masat të cilat janë vë si rezultat i ofrimit të shërbimeve komunale, por nuk është trajtuar si temë e veçant me theks të veçant.	+
m. Përmirësimi i shërbimeve publike dhe aksesit ndaj transportit në zonat rurale	Po	Mungon trajtimi me theks të veçant i shtigjeve të biciklistëve, i rrugëve të shkurtra që lidhin fshatrat. Poastu nuk është paraqitur në harta.	-
7. Ndikimet në klimë			
a. Përshtatja me ndryshimet klimatike globale.	Jo	Ka trajtim trajtim tëndryshimeve klimatike globale. Ndërsa ende nuk ka strategji nacionale të aprovuar për masat që duhet marr për tu përshtatur me ndryshimet klimatike globale. Nuk është objekt parësor i parashikuar	-

		nga TeR, por në studimin mjedisor janë integruar objektiva dhe instrumenta zbatimi të cilat shkojnë në këtë drejtim si ai i uljes së “gjurmës së karbonit” të komunës.	
b. Marrja parasysh e ndryshimeve lokale.	Po	Përfshihet si tregues mjedisor, por nuk trajtohet në mënyrë parësore.	+
c. Rrezatimi	Jo	Nuk është trajtuar fare edhe pse në këtë komunë ka pasur vende të goditura me uranium të varfëruar dhe këto vende tani dihen, kjo tem duhet trajtuar me PZHK	-
8. Demografia			
a. Problemet me zhvillimin demografik	Po	Njih faktin se kjo është ende e vështirë për t’u parashikuar saktë. Megjithatë, mund të ketë nevojë për më shumë fleksibilitet, për t’i lënë hapësirë ndryshimeve të mundshme.	+
b. Skenarët e zhvillimit demografik	Po	Merr parasysh faktin që popullsia mund të rritet jo edhe aq shumë deri në vitin 2025. PZHK-ja i mban larg presionit demografik zonat me ndjeshmëri mjedisore.	*
9. Zhvillimi dhe shfrytëzimi i Tokës			
a. Planifikimi komunal dhe Drejtimi i Zhvillimit	Po	Njih nevojën për pranimin e zhvillimit aktual, përveç zonave ku mund të shkaktohen probleme mjedisore	*
b. Kapacitetet mjedisore në zonat dhe vendbanimet e propozuara për zhvillim	Po	Vlerësohet se vetëm në disazona si ajo ku shtrihen gurthyesit ka një gjurmë të cenimit ekologjik, duke e rrezikuar kapacitetin e saj mjedisor. Ndërsa në vendbanime nuk ka një gjurmë të cenimit ekologjik, duke qenë brenda kapaciteteve mjedisore. Zona e propozuara për zhvillim industrial apo ekonomik shtrihet në tokën jobujqësore dhe propozohet studimi i VSM/VNM-së së veçant për aspektet tjera mjedisore, ndërsa në vendbanimet brenda konceptit vrehen tendencat e shtrirjes në kategorinë “tokë bujqësore” të konvertuara vonë në zona informale, por edhe këtu tentohet të ruhet sa ma shumë tokë bujqësore dhe kompaktim dhe dendësimi sa ma i madhë i zonës ndërtimore.	*
c. Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave të reja rekreative	Po	Njih problemin e mungesës së tokës për këtë qëllim vetëm brenda vendbanimeve dhe propozon mbrojtjen e zonave të gjelbra dhe parqeve duke krijuar një kurorë të gjelbër të përbërë nga disa zona dhe sisteme kodrinore malore të mbrojtura. Megjithatë, për të gjithë këta	+

		elemente, përfshirë dhe zonat që gjenden brenda vendbanimeve dhe në zonat jashtë tyre janë të përcaktuara kufijtë. Duhet marrë vendimet përkatëse për shpalljen e zonave të interesit komunal, dhe duhet aprovuar Planet e Menaxhimit lidhur me zhvillimet brenda këtyre kufijve.	
d. Zhvillimi i parqeve të reja brenda vendbanimeve policentrike	Po	Edhe se pjesërisht e thamë më lart se njohim problemin e mungesës së tokës brenda zonës së vendbanimeve, propozon një varg masash për rritjen e sipërfaqes së gjelbrë. Masat duhet të konkretizohen me veprime për çdo kategori zonash në vendbanime.	+
e. Mbrojtja e pyjeve, peisazheve dhe zonave të mbrojtura natyrore	Po	Njihet problemet dhe bëhen propozimet adekuate për pyjet dhe hapësirat e gjelbra. Duhet çuar përpara statusi i tyre dhe duhet hartuar dhe aprovuar Plane menaxhese përkatëse, ndërsa parqet ekzistues duhet trajtuar në mënyrën adekuate në tërë territorin e komunës.	+
f. Zhvillimi i zonave të reja komunale	Po	Nxitet ky zhvillim veçanërisht në fushën e hapsirave dhe terreneve sportive, për të lehtësuar presionin në disa vendbanime. Me zhvillime të reja janë tashmë të gjitha vendbanimet me elemente të domosdoshme urbane. Ekziston rreziku që të mund të inkurajojë shtrirje të mëtejshme jashtë kufijve ndërtimor, dhe për këtë shkak VSM ka sugjeruar shpalljen e kufizimit të ndërtimeve në këto drejtime të komunës. Mund të shkaktojë humbje të mëtejshme të tokës bujqësore.	*
g. Zhvillimet industriale	Po	Kompaktësimi dhe formalizimi i zonës spontane industriale mundëson vendosjen e masave të kontrollit mbi këto zona. PZHK i përputhet me parimet strategjike ku aktivitetet ekonomike që shkaktojnë ndotje nuk do të lejohen dhe do të dekurajohen. Ka një problem me trajtimin e zhvillimeve aktuale për këtë lloj industrie! PZHK duhet të tregoj sakt kufijtë e Zonës Industriale.	+
i. Shërbimet dhe lehtësirat Publike (shkolla, stadione sportive)	Po	Propozon norma dhe nevojën për standarde në tërë territorin e komunës.	*
h. Pyjet, malet dhe parqet/zonat e mbrojtura	Po	Trajtohen si zona të mbrojtura për pyje dhe parqe. Dekurajohet me forcë ndërtimi në këto zona për pos kur është definuar me këtë planë. Duhet të trajtohen zonat prioritare edhe nga	+

		pikëpamja e peisazheve pra e pikave panoramike me rëndësi peizazhike dhe turistike për komunën.	
k. Forma e vendbanimeve dhe dendësia	Po	Propozime konkrete në kodin e zonimit për lartësinë e ndërtimeve. Ato bazohen në ruajtjen e formës së vendbanimeve, mbushjen e zonave me densitet të ulët, dhe identifikimin e zonave ku do të lejohet zhvillimi i ndërtimeve në lartësi.	*
l. Mbrojtja e detajuar e Zonave të Gjëlbra			
m. Lumenjtë	Po	Të kthehen në korridore të gjëlbrë, por ndërkohë duhen përcaktuar kufijtë e shtratërve të lumenjve dhe të hartohet Plan Menaxhimi dhe Monitorimi mjedisor	+
n. Parqet dhe zonat e mbrojtura			
a) Kombëtare	Po	Parku mirusha dhe peisazhet e luginës së lumit Klina	*
o. Brezi i gjëlbrë	Jo	PZHK duhet të parazhë breza të gjëlbrë përgjat rrugëve magjistrare, regjionale, por edhe përgjat hekurhudhës për menjanimin e zhurmës dhe ndotjes që vjen nga komunikacioni.	-
p. Pjesa e brendshme e vendbanimeve	Po	Jepen standardet për zonat lokale. Njihet problemi i mungesës së hapësirës për rritjen e sipërfaqeve të gjëlbra apo për zona komunitare si sheshe, kënde lojërash, etj. dhe bëhen propozime në lidhje me instrumentet planifikues në planet e detajuara vendore.	+
10. Rreziqet natyrore apo humane			
a. Rreziqet natyrore në tërësi	Po	Trajtohen në përgjithësi, por ka nevojë për vëmendje më të madhe.	+
b. Rrëshqitjet e tokës	Po	Trajtohen në mënyrë sipërfaqësore, por nuk tregohet për vendet se ku kemi rrëshqitje të tokës dhe konkretisht çka duhet të ndërmerret në ato zona.	+
c. Përmbytjet	Po	Tregohen për masat që duhet të ndërmerren në përgjithësi për parandalimin e dëmeve që prodhojnë vërshimet, megjithatë PZHK duhet ti trajtoj vërshimet si: vendet ku ka vërshime, sa sipërfaqe vërshohet, dhe qfar masa konkretisht duhet të merren për zona të caktuara.	+
d. Tërmetet	Po	Në kodet e ndërtimit, por nuk gjen zbatim retrospektiv tek ndërtesat ekzistuese. Nuk ka detyrime për ndërtime me dalje emergjence në rast tërmeti.	+

c. Të ardhurat e ulëta	Po	Njeh problemin se strehimi në ndërtesa të reja të ligjshme është i mundshëm vetëm për grupet me të ardhura të larta. Rekomandon nevojën që të ndërmerren politika sociale të strehimit.	*
d. Cilësia	Po	Kerkohet miratimi dhe respektimi rigoroz i kodeve të ndertimit.	*
e. Shkalla sizmike	Po	Rekomandon kriteret projektimi në përputhje me nivelin 8 në shkallën MSK-64 ₂₁ , pasi ky është një rrezik i njohur. Do të ishte mirë të sugjeroheshin projekte sipas Shkallës Evropiane Makrosizmike (EMS) për të respektuar standardet Evropiane.	+

Masat e nevojshme në PZHK për Mbrojtjen e Mjedisit

Tabela e mësipërme përmban një analizë e cila jep rekomandime të mëtejshme. Kriteret që janë shënuar me shenjën * nuk diskutohen më tej, pasi nuk konsiderohen si problematikë. Tabela e mësipërme përmban një përmbledhje të të gjitha problemeve mjedisore dhe shkallën në të cilën plani u jep përgjigje secilit prej tyre. Megjithatë, një nga pikat e tabelës së mësipërme që ka të bëjë me skenarët dhe parashikimet e rritjes së popullsisë, megjithëse është trajtuar, ka nevojë për diskutim të mëtejshëm.

Konceptet urbane të përdorimit të tokës, përfshi zhvillimin e qendrave

Gjatë analizës së vendbanimeve është vërejtur se këtu kemi problem me shtrirjen shumë disperse të ndërtimeve të cilat më tutje paraqesin problem në ofrimin e infrastrukturës dhe elementeve tjera urbane. Cilësohet si problem me përmasa serioze zgjerimi i tokës ndërtimore në mënyrë spontane, pastaj shtrirja e ndërtimeve në tokat bujqësore sidomos në zonën përgjat Magjistrale, sidhe në fushat përgjat luginave lumore.

Harta e shfrytëzimit të tokës tregon destinimin e propozuar të tokës për vitin 2021. Ktu prezantohen edhe kufijt e rij ndërtimor edhe zhvillime tjera. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës me plleshmëri, tokës së pasur me resurse dhe pyjeve. Kemi te prezantuar edhe zonat e shënuara me ngjyrë e cila potencialisht mund të paraqesin pikat e nevojta mjedisore.

Konfliktet e mundshme për hapsira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshjeje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe tjera për komunën, të cilat do të vireshin më pas në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale, gjë që pranohet deridiku edhe në Planin Zhvillimit Komunal të Klinës. Gjatë procesit të hartimitjanë organizuar takimet me komunitetin për të filluar këtë proces. Rreziku kryesor mjedisor do të ishte nëse nuk arrihet marrëveshja për një vizion të përbashkët për Klinën.

Rritja e Klinës besohet se do të vazhdojë, e në fakt sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë Komuna e Klinës, aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo do të ishte e dëshirueshme dhe është në të mirë të Kosovës, duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimi efektiv komunal, komuna e Klinës ka mundësi të akomodojë një numër shumë më të madh popullsie me zgjerimin e kufinjve ndërtimore dhe turistëve me zgjerimin e kapaciteteve receptive turistike. Burimet ujore nuk janë të mjaftueshme. Kapaciteti mjedisor mbajtës i Klinës nuk përbën problem, ndërkohë që problem përbëjnë menaxhimi dhe planifikimi urban jo-efektiv dhe nevoja për financimet mëdha në infrastrukturën mjedisore. Planin e këtyre problemeve dhe përpaketimit në mënyrë realiste të punojë brenda këtyre kufizimeve.

Ndikimi në klimë

Nuk ka indikacione se komuna e Klinës me aktivitetin aktual dhe atë që do të ketë në perspektivë të ndikojë në klimën globale, pasi që komuna e Klinës nuk ka ndonjë industri apo objekt industrial që do të emitonte gazra të serrës në atë masë sa të ketë ndikim në klimën globale. Është e rëndësishme që të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturës dhe faktorëve tjerë klimatik. Megjithatë skenari “mos bëj asgjë” i cili nuk ndihmon në ruajtjen e zonave të gjelbra dhe që lejon zhvillimin e pakontrolluar në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojë një ndikim në mikroklimë, jo vetëm në rritjen e temperaturave, por edhe stuhi më të rralla, por më të fuqishme, të cilat do të shkaktojnë përmbajtje.

Mbrojtja e pyjeve, zonave të gjelbra ekzistuese dhe zhvillimi i zonave të reja

Kodet e zonimit të propozuara nga PZHK-ja krijojnë mundësinë për struktura të gjelbra, kryesisht për përdorim të ndryshëm, Pyllëzim, ripyllëzim etj. Duhet hartuar udhëzues për:

- Projekte pyllëzimi konform planit;
- Projekte ripyllëzimi dhe mirë mbajtje konform planit;
- Numrin e këtyre strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Përdorimin e tyre, të themi për grupe/festa të mëdha, gjë që do të kishte ndikime negative;
- Arkitekturën e tyre për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues;
- Shërbimet e infrastrukturës për ofrimin e energjisë, ujit dhe menaxhimit të mbeturinave, me qëllim shmangien e ndikimeve vizuale dhe ndotjet e mundshme.

Duhet përgatitur propozimet lidhur me mënyrën se si do të trajtohen zhvillimet në zonat e lartpërendura. Plani i Zhvillimit të Komunës ku hynë edhe Lumenjtë që shtrihen në komunën e Klinës shërbejnë pikërisht për këtë qëllim.

Cilësia e ajrit

PZHK-ja mundet të adresojë problemet e cilësisë së ajrit vetëm në mënyrë të pjesshme. Prania e komunikacionit hekurudhor dhe magjistrales Prishtinë – Pejë në këtë komunë është një element që tregon se ka shkarkim të konsiderueshëm të gasrave në atmosferë, si dhe lirim të zhurmave të ndryshme që vijnë nga komunikacioni. Ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2021 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SO_x, NO_x, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte për çlirimet në ajër nga automjetet, permiresimi dhe kontrolli i cilesise se karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të bicikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve) ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. Grumbullimi i grimcave PM₁₀ (të ngurta, të lëngshme ose gaz) mund të depërtojë në mushkëriduke shkaktuar efekte të mëdhashëndetësore të tilla si sulmet në zemër, kanceri në mushkëri, bronkitin kronik dhe ndikime më serioze të moshuarit, fëmijët dhe diabetikët. Efekte të voglashëndetësore përfshijnë inflamacion në hundë dhe fyt, alergji dhe infeksione përkeqësimi. Këto efekte shëndetësore ndikojnë në cilësinë jetësë çdokujt dhe ndërhyjnë në mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të banorëve të komunës së Klinës. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së mundshme me qëllim vlerësimin sasior të dëmit në shëndet dhe kostos ekonomike që sjell ndotja e ajrit për Komunën. PZHK-ja nuk e ka adresuar problemin e zhurmës detajisht, por ka dhënë disa rekomandime dhe ka propozuar masa se si zhurma të reduktohet. Megjithatë, si futja e korsive të bicikletave, furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike dhe shmangia e përdorimit të gjeneratorëve, krahas masave administrative komunës së Klinës për pakesimin e zhurmave në një kategori të mjedisve publike që aktualisht janë problematike, do të ndikojë në uljen e nivelit të zhurmave, krahasuar me vlerat aktuale.

Propozimet për rrugë

PZHK-ja propozon një kategorizim të rrugëve lokale dhe ndryshim ose zgjerim të traseve të disa rrugëve regjionale. Meqë komuna e Klinës është një territor tranzit në mes të qendrave nacionale vjen në shprehje edhe infrastruktura tjetër e cila diktohet nga niveli nacional dhe e cila ka impaktet më të larta mjedisore. Me probleme të përafërta përballen edhe rrugë të tjera të propozuara, të cilat kalojnë nëpër zona të gjelbra në të cilat janë masat adekuate për ruajtjen e tyre.

Probleme të mjedisit në Klinë dhe përgjigja që jepet përmes PZHK-së

Tabela e mëposhtme bën një përmbledhje të problemeve mjedisore që u identifikuan në Kapitullin më lart dhe të shkallës në të cilën PZHK-ja i u përgjigjet atyre, duke sugjeruar njëkohësisht edhe masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

Tabela nr. Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas PZHK-së

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Propozimet e PZHK-së	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
1. Cilësi e ajrit.	Aktiviteti ndërtimor i pakontrolluar; Rrugë të pashtuara; Rritja e shpejtë e numrit të automjeteve; Karburante të cilësisë jo të mirë; Gjeneratorë me naftë; Ngrohjet individuale.	Të gjitha shkaqet e përmendura e ulin cilësinë e ajrit edhe pse kjo komunë është e mbuluar mjaft me vegjetacion.	Nuk ka të dhëna që provojn këtë lidhje për sëmundjet, apo ndonje sëmundje tjetër që vjen si rezultat i cilësisë së ajrit.	Propozimet për pyllëzim Propozimet për shirita gjelbrues Propozimet për transportin publik dhe ciklizmit ka si qëllim ngadalësimin e rritjes së numrit të makinave private dhe reduktimin e ndotjes së ajrit të disa zonave të komunës. Rrugët e reja të cilat duhet të lehtësojë trafikun nëpër vendbanime.	Duhet të bëhen studime mbi pyllëzimin; Duhet të bëhen studime mbi transportin; Përdorimi i karburanteve më të pastra (përmbajtje e sqfurit të bjerë); Përmirësimet e rrugëve nga Komuna e Klinës në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës.	Studim për të përcaktuar ndikimin dhe koston e cilësisë së dëmshme të ajrit në shëndetin publik dhe në ekonominë në tërësi; Përmirësimi i teknikave të ndërtimit për të pakësuar ndotjen; Shtrimi i rrugëve, përmirësimi i trafikut edhe futja e korsive të biçikletave; Edukim më i mirë i publikut mbi shëndetin dhe cilësinë e ajrit; Përmirësimi i furnizimit me energji-zbutja e kërkesës nëpërmjet burimeve alternative të energjisë dhe përdorimit të gjeneratorëve; Vendosja e kriterëve strikte për pyllëzimin; Vendosja e kriterëve strikte për cilësinë e zonave të gjelbra (cilësia e mbulesës së tokës, dhe e mbulesës bimore).

2. Cilësi jo e mirë e ujit të lumenjve	Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura fekale dhe mbetjeve industriale që shkaktohet nga mungesa e sistemit të grumbullimit dhe trajtimit adekuat të ujërave të ndotura.	Ndikim në shëndetin e popullatës njerezore, humbje e flores dhe faunes në ekosisteme ujore (mikrozoobentosit dhe makrozoobentosit); Ndotja e rezervave të ujërave nëntokësorë.	Ndikon në sëmundjet infektive, sëmundjet tjera të cilat lidhen me përdorim të ujit dhe përmes zingjirit ushqimor.	Skenari i zhvillimit të PZHK në përputhje me studimin e Planit hapësinor të Kosovës. Vendi i identifikuar për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura është në përputhje me Planin hapësinor të Kosovës pjesa e trajtimit të ujërave të ndotura. Trajtimi i përkohshëm dhe sipas zonave I ujërave të ndotura.	Përgatitja e Projekteve Sektoriale për Trajtimin e ujërave të zeza të Klinës	Zëvendësimi i tubacioneve të vjetra dhe të vogla që do të shoqërohet edhe me minimizimi i rrjedhjeve. Maksimizimi i lidhjeve. Rregullimi i lidhjeve të paligjshme. Reduktimi i përdorimit të gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve për ujërat e ndotura, lidhja me kolektorin kryesor të fshatrave, dhe ndertimi i impiantit të planifikuar.
3. Cilësi dhe sasi jo e kënaqshme e ujit të pijshëm	Humbje në sistemin të furnizimit, tubat jo të cilësisë së duhur dhe mungesa e kontrollit të ujërave	Ndotja e ujërave nëntokësore Konsum i ujit në shishe dhe gjenerimi i mbetjeve plastike.	Shpërthim i sëmundjeve gastro-enterike, por lidhja e qartë nuk është provuar nga të dhënat shëndetësore.	Skenari i zhvillimit i PZHK përputhet me studimet e mëhershme për cilësinë dhe sasinë; Në PZHK janë parashikuar edhe përfshirja e infrastrukturës për shkak të interferencave që ka.	Duhet përgatiten projektet Sektoriale përkatës dhe trajtohet mundësia e financimit.	Zvogëlimi i humbjeve në rrjet. Shmangia e intersektimeve me linjat e ujërave të zeza. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme. Përgatitja e projekteve për të shkuar drejt furnizimit të vazhdueshëm me ujë; Mbrojtja e burimeve mbi sipërfaqe, eliminimi i shfrytëzuesve individual të burimeve ujore.

4. Mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave	Mungesa e një sistemi reduktim-riciklim për mbetjet e ngurta në nivel të Komunës së Klinës; Grumbullimi i mbetjeve në komunë nuk është plotësisht i rregulluar pasi shumë prej tyre hidhen në lumenj dhe zona të tjera. Nëse vazhdohet me këto ritme, Klina do të ketë disa deponi ilegal brenda viteve të ardhshme. Mbetjet ndërtime, dhe ato të tjera përzihen me mbetjet komunale.	Komuna gjeneron sasi të konsiderueshme të mbetjesh të ngurta. Në disa vendëbanime të Klinës pamjet e mbeturinave mbeten të shëmtuara. Në komuna, sidomos në shtratin e lumit Drini i Bardh dhe lumi Klina por edhe në lumenjt tjer pamja është shumë e shëmtuar. Mund të jenë burim semundjesh veçanërisht në stinën e nxehtë.	Djegia e mbeturinave shton ndotjen e ajrit. Personat që jetojnë pranë ktyre deponive dhe her pas here kontrollojnë mbetjet janë të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze për shëndetin. Rrezik potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme në zona afër dhe në disa raste edhe brenda vendbanimeve të komunës së Klinës.	PZHK sugjeron adoptimin e një sistemi të integruar të administrimit të mbetjeve në bashkpunim me kompaninë regjionale, bazuar në itinerarin reduktim-riciklim-rikuperim. PZHK përmend riciklimin, selektimin, por nuk tregon për vendet apo zonat se ku do të grumbullohen selektohen dhe riciklohen mbeturinat në të ardhmen.	Duhet përgatitet Projekti Sektorial përkatës me mundësi financimi; duhet të propozoj vendet për deponim të përkohshëm në të cilat mundë të bëhet selektimi, grumbullimi dhe riciklimi i mbeturinave.	Grumbullim më i mirë në vendbanime dhe nivel komunal. Vënie në jetë e strategjive për reduktimin e mbetjeve dhe për riciklimin. Ndarje më e mirë e materialeve të rrezikshme. Për të shmangur hedhjet e paligjshme, organizimi mund të bëhet nga komuna për një numër të mjaftueshëm kamionësh, dhe të menaxhohet me transport nga deponia e përkohëshme drejt asaj regjionale njejtë të menaxhohet me pagesë për tone për hedhjen e mbeturinave në Deponin e regjionale duke krijuar sistem pagesash nga ata që hudhin mbeturina. Zbatimi i projekteve për pika grumbullimi në sistemin e stacioneve të transferit .
---	--	---	--	---	---	--

5. Rehabil- itimi /Inkapsulim i pikave te nxehta të ndotjes	Ndotja e tokes nga aktivitete e ndryshme ekonomike dhe bujqësore	Ndotja e tokes dhe ajrit nga perberje të demshme per shëndetin e njeriut dhe biodiversitet	Ne vartesi te lendeve ndotese,mund të shkaktojnë një game të gjerë semundjesh	Propozohet të studiohen të gjitha hapësirat,zonat me rrethinë ku janë zhvilluar industritë të vogla ose edhe sot ku pjesërisht funksionojnë në territorin e komunës së Klinës që kane perdorur ose gjeneruar kimikate te rrezikshme per shendetin, para,gjatë edhe pas viteve 90-ta dhe mbi bazen e shkalles se rrezikut të behen nderhyrja teknike	Te mblidhet informacione më të thelluara për ketë gjendje, per nivelin dhe llojin e ndotjes,për ndikimet në tokë,ujë ajrë egzistencen e lidhjeve të territoreve te ndotura me kërcnimet për shëndetin,llojin e kërcnimit të bëhen analiza ne terren dhe laborator, të trajtohen me PZHK dy vendet ku është goditur me Uranium të Varfëruar gjat luftës së fundit në mënyr që në të ardhmen të bëhen studime lidhur me ndikimin në mjedis të këtyre zonave dhe të bëhet inkapsulimi apo izolimi i këtyre zonave nëse është e nevojshme.	Plani i menaxhimit dhe rehabilitimit të pikave të nxehta bazuar edhe në studim,analiz dhe VNM të detajuar; Masat adekuate për shëndetin e njerëzve; Masat tjera për konsolidim të tokës,mbrojtje të ujit dhe cilësisë së ajrit dheBiodiversitetit dhe ekosistemeve tjera.
--	--	--	---	---	--	---

6. Shtrirja e ndërtimeve	Nevojat për banim; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar brenda dhe rreth vendbanimeve sidomos nëpër terrene me tokë të plleshme bujqësore dhe ato kodrinore.	Humbje e tokës së plleshme dhe gjelbrimit e pemëve të ndryshme, humbje e shtresës së sipërme të tokës, rrjedhje dhe mundësi për rrëshqitje/ përmytje. Humbje e vlerave estetike. Humbje e vlerave peizazhistike të teritorit komunal.	Jo i drejtperdrejte dhe i menjëhershëm; Por shtrirja pa përcjellë me infrastruktur normal që shkakton edhe pasoja në shëndet; Edhe rrëshqitjet e mundëshme të tokës dhe përmytjet mund të shkaktojnë dëme serioze për jetën dhe pronën. Edhe humbja e gjelbrimit ka ndikimin e vetë në shëndetin e njeriut	Planifikohet kufiri ndërtimor për të gjitha vendbanimet; Standartet dhe normat e planifikimit të përdorura në PZHK bëhen automatikisht të vlefshme; Për të gjitha vendbanimet në Komunë. Parqe,zona të gjelbra rreth disa vendbanimeve	PZHK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor rreth vendbanimeve statusin e zonave ku nuk lejohet ndërtimi; PZHK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të ndërtimit të marrin statusin e parkut,zones së gjelbër	Të përgatitet ekipi dhe një plan i Menaxhimit të ndërtimeve; Të përgatiten projekte për gjelbrim dhe parqe Moratoriumi për ndërtimet duhet të shtrihet edhe në gjitha zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor. Është e nevojshme të hartohen Plane Rregulluese edhe për vendbanimet në konceptin e zhvillimit me nënqendra.
--	---	--	---	---	---	--

7. Degradimi i pyjeve,	Prerja e pakontrolluar dhe ilegale e pyjeve; Djegëjet e pyjeve; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i disa vendbanimeve.	Ndotja e ajrit; Ndotje e ujit, mungesë e kënaqësisë si për rezidentët ashtu edhe për vizitorët. Erozioni në shkallë të lartë dhe prishje e balancit natyror.	Ndotja e ajrit edhe e ujit kan ndikim dhe pasoja në shëndet;	Revitalizimi i pyjeve ekzistuese; Propozohen mbulim me fidane të reja sipërfaqet e zhveshura; Dhe parqe tjera të reja në disa vendbanime.	Projekte konkrete pyllëzimi, revitalizimi, sanim për pyjet e Klinës në zonat e parapara me PZHK. Përgatitja e projekteve për shfrytëzimin e burimeve tjera alternative për ngrohje dhe energji tjera në mënyrë që mos të shfrytëzohet druri për djegie.	Ngritja e një mekanizmi bashkpunues në nivel të komunës dhe ministrive për këto projekte; Kushtëzimi i projekteve të reja të infrastrukturës me gjelbrim dhe tampon zona; Aktivizim i gjykatave, policisë inspektorëve në mënyrë cilësore. Në ish venddepozitimet legale dhe ilegale masat rehabilituese dhe ri gjelbrim ose rivitalizim të atyre ekosistemeve.
8. Degradimi i lumenjve, eksploatimi i rërës dhe Zhavorit, Gurëthyesit dhe degradimi natyror i tokës	Ekspluatimi i rërës dhe zhavorit nga lumenjt e Klinës sidomos nga Drini i Bardhë dëmtimi i ekosistemit lumor. Degradimi i pjesëve të ndryshme të tokës gjat eksploatimit të gurëve nga gurëthyesit dhe shitësit e gurëve për dekorim.	Degradim i shtratit të lumit, dëmtim i faunës që si habitat kanë lumin apo lumin e përdorin si burim ushqimi, prishja e zingjirit ushqimor, degradim i tokës, pyjeve dhe hapësirave me pesazhe të bukura duke i shëndërruar në hendeqe të pakëndshme.	Natyrshtëm ka ndikim në shëndet të popullatës njerzore dhe organizmave tjerë.	PZHK ka trajtuar ndotjen që vjen nga gurthyesit, duke lënë hapësirë për trajtim të mëtutjeshëm në të ardhmen.	Duhet të parashihen masa për kthimin në gjendjen e më parshme të vendeve ku janë nxjerrur gurët, kurse të lumenjt të rregullohen shtetrit e tyre dhe të ndërpritet eksploatimi i rërës dhe zhavorit nga shtrati i lumit.	Në bashkpunim me nivelin qendror të merren masa për rehabilitimin e vendeve ku është eksploatuar. Të rregullohen argjinaturat e lumenjve dhe të parandalohen hudhjet e mbeturinave dhe kanalizimeve në lumenj.

9. Humbje e trashëgimisë së ndërtuar	Zhvillimet me trende të ndryshme nëpër vendbanime nuk janë në harmoni me arkitekturën ekzistuese.	Humbja e disa nga karakteristikat unike të vendbanimeve, cenim i identitetit dhe e kujtesës historike, kryesisht humbja e kullave karakteristike për këtë zonë.	Të dhëna të pa disponueshme por aspektin psikologjik dhe shpirtor mendohet se do jetë prezent.	Identifikon zonat brenda studimit të cilat do të ruhen. Propozon masat për ruajtjen. E orienton presionin për ndërtime drejt vendbanimeve dhe zonave më pak të pasura me këtë lloj trashëgimie	Identifikimi i instrumentave ekonomike dhe të valorizimit të territorit (psh, itinerare apo shtigje kulturore) që mund të bëhen mbështetje për komunitetet autoktone të Klinës që banojnë në këto vendbanime dhe zona.	Zgjerimi dhe mbajtja/pasurimi i listës së monumenteve të kulturës, e cila është përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe institucione tjera qendrore dhe lokale për të mirëmbajtur zonat,ndërtesat që kanë vlerë të trashëgimisë së ndërtuar
---	---	---	--	--	--	--

10. Rrezik për tërmete, rrëshqitja e tokës, vërshimet dhe element tjer rreziku	Sikurse i tër territori i Kosovës edhe Klina bënë pjesë në zonë sizmike aktive të nivelit mesatar; Ka erosion e burime tjera rreziku.	Varsisht por dine të jetë me ndikim të lartë mjedisor sidomos nga ndikimet indirekte	Mund të rezultojë katastrofik	PZHK nuk paraqet në mënyr specifike zonat e rrezikuara nga tërmetet, nuk tregon për zonat ku ka erozion dhe shkarje dhe dhe çfar shkalle si dhe nuk tregon por zonat të cilat janë nën ndikim të vërshimeve dhe mbytjeve.	PZHK duhet të tregoj dhe paraqes grafikisht për zonat të cilat janë nën ndikim të rreziqeve të përmendura. Komuna duhet të ndërtojë brenda standarteve të larta anti-sizmike,	Studim i terreneve për qëndrueshmëri sizmikenë rast se do të duhet të ndërtohet ndonjë pikë karburanti, duhet patur parasysh raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit, i cili duhet të ketë standarde shumë të larta.
11. Rreziqe nga uranumi.	Hedhja e predhave nga NATO-ja gjat luftës në Kosovë në afërsi të fshatit Qupevë dhe Drenovë	Mund të shkaktoj probleme të shumta shëndetësore, por më kryesore është kanceri.	Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj radioaktivitetit mund të shkaktojë kancer.	Nuk është trajtuar fare me PZHK.	Kërkohen studime dhe hulumtime shtesë për të përcaktuar rrezet e veprimit	Duhet të bëhen studime të mëtejme në nivel vendi dhe sipas nevojës do duhej hartuar strategji e veçant për këtë problematikë.
12. Rreziqe nga Zjarret.	Shkatërrimi i pyjeve, rrezikimi i pasurisë dhe pronës së qytetarëve, ndotja e ajrit.	Shkatërrimi i pasurisë qytetare duke djegur pronën dhe pasurit tjera të paluajtëshme.	Rrezikimi i jetës së qytetarëve dhe pasurisë.	Bënë identifikim të zonave me probabilitet të zjarrendezjes dhe krijon kushte që zjarret të menaxhohen më lehtë.	Duhet ndërhyrje bonifikuese në ndërtesat me përmbajtje amianti - asbesti.	Duhet bëhen studime të mëtejme mbi shkaqet e zjarrvënjes, kohen dhe lokacionet më të atakuara.

13. Rënie e biodiversitetit dhe humbje e florës dhe faunës.	Rritja e disa vendbanimeve por edhe zhvillimet me karakter ndërtimi po shkaktojnë humbje në pyje dhe habitat. rritje e ndotjes, zhurmës dhe forma tjera të bezdisjes dhe gjuetia e pa kontrolluar.	Nuk njihet plotësisht, por ka probleme të përgjithshme të humbjeve ekologjike. Rënie e efektit zbutës të florës për gjurmën e karbonit në disa zona të komunës	Humbje e zingjirit ushqimor, Aspekti kulturor, shkencor dhe rekreativ. Ndikim negativ në gjendjen psikologjike të banorëve.	Përkufizimi i ndërtimit është propozim i drejtpërdrejtë, dhe ulja e zhvillimit të çrregullt të vendbanimeve do të sjellë edhe uljen e humbjes në biodiversitet.	Projekte të asistuar nga BE, me qëllim fuqizimin e monitorimit të mjedisit në komunëduhet zhvilluar studime të situatës.	Nevoja për të pasur një studim bazë për Klinën me qëllim identifikimin e humbjeve në biodiversitet dhe inventarizimin e florës dhe faunës, mundësite për permiresimin e situatës.
14. Zonat e ndikimit të aktiviteteve në Klinë	Të gjitha problemet e lartpërmendura, por nuk ka informacion të detajuar mbi ndikimin	Ndotje e lumenjve dhe tokës	Nuk dihen në hollësi por nënkuptohen	Jashtë studimit, por problemet janë të njohura, sidomos rritja vendbanimeve dhe zhvillimet tjera industriale dhe ndërtimore.	Projekte të asistuar nga MMPH, BE etj për identifikimin e nivelit të ndikimit dhe zones së veprimit loka, komunal, kombëtar ose edhe ndërkombëtar	Nevoja për të pasur një studim bazë për Klinën me qëllim identifikimin e ndikimit të aktiviteteve në zona dhe mundësite për permiresimin e situatës

15. Ndotje akustike në Klinë	Komunikacioni hekurudhor, qarkullimi i dendur dhe kaotik rrugor vlen të ceket me theks rrugët maxhistrale dhe regjionale mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, numri i lartë i automjeteve private për shkak të mosefiçensës së transportit publik, ushtrimi i aktiviteteve argëtuese jashtë standarteve, cilësia e ulët e automjeteve,	Nivel i lartë i zhurmës në vendbanimet pran arterieve kryesore rrugore, hekurudhore si dhenë zonat turistike.	Efekte kronike dhe akute në sistemin e dëgjimit, dhe dëmtim i sistemit nervor.	Krijim i një rrjeti më të disiplinuar dhe më të mirë rrugor.	Edukimi qytetar për mosshkaktimin e ndotjes akustike. Aplikmi ne ndertesat ekzistuese dhe te reja te materialeve izolues tëzhurmave.	Masa të karakterit rregullator për standartet e mjeteve që lëvizin në komunë dhe penalitetet daj shkaktuesve të zhurmave në vendbanimet e Klinës. Përmirësim i transportit publik; Krijimi i barrierave me bimësi aty ku është e mundur anës rrugëve si dhe pengesa tjera të përshtatëshme.
-------------------------------------	---	---	--	--	--	---

MONITORIMI

MONITORIMI

Monitorimi i aspekteve të mjedisit është element kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve. Në ligjin e “Vleresimit Strategjik Mjedisor”, kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shendetesore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në fazë të hereshme pasojat negative të paparshikuara dhe me qëllim marrjen e masave rregulluese.

E njejta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktives se BE për VSM-n. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen dublikimet në procesin e monitorimit, mund të perdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPH-ja nëpërmjet AKMM Agjensise Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila zbaton Monitorimin në bashkepunim me institucionet përkatëse të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal.

Me qëllim që PZHK-ja të zbatohen me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë përcaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe siç e parashtruam edhe më sipër; është kërkesë ligjore, që të monitorohet zbatimi i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

Për të qenë sa më racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre tregueseve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbutuese të PZHK-së. Plani Monitorimit përmbledh shumë treguesë që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kesaj ndermarrje kerkon angazhimin e mjaft institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatës monitoruese nën drejtimin e Agjensise Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit.

Mbeshtetur në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Klinës ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryen në kuadrin e zbatimit të PZHK-së. Këtu perfshihen qoftë Planet, projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i PZHK-së në Plane Rregulluese për vendbanimet me nënqendra, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Klinës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerezore dhe financiare të gjithë këto veprimtari. Megjithatë ajo, duke angazhuar Drejtorin e Planifikimit të Mjedisit dhe struktura të tjera në vartesi të saj mund të kryej një pjesë të programit të monitorimit si çilesinë e ndertimeve, ecurinë e pyllzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zgjerimit të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, ecurinë nderimit të rrugëve të reja perfshire ato për qarkullimin me bicikleta dhe të tjere indikatorë që janë paraqitur në programin e monitorimit të PZHK-së.

Rezultatet e monitorimit, komuna e Klinës sipas ligjit për VSM-n, duhet të publikoj në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjera të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën VSM, VKM për monitorimin dhe rezultatet të përcillen komunës së Klinës dhe Agjensise Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor të publikoj në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

Receptoret mjedisor	Objektivat e Mbrojtjes së Mjedisit	Synimi	Indikatori	Raportimi	Institucioni pergjegjes
Shendeti i banoreve	Promovimi per krijimin e nje komune të qendrueshem dhe të shëndetshme	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem konform stand. te BE ujrut sipërfaqore dhe nentokesore destinuar per uje te pishem 2. Cilesia e ujit te pishem konform standardit 3. Dendesia e popullsisë e qendrushme në vendbanimet me trend të rritjes së popullsisë	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem, kundrejt standardit te BE. 2. Cilesia e ujit te pishem ne perputhje me standardin 3. Dendesia mestare për këto vendbanime	1. Rap.Vjetor 2. Rap.Vjetor 3.Rap.Vjetor	1. Drejt. E Urbanizmit eKlinës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. 2. Drejt. Shërbimeve Publike e Klinës; 3. komuna e Klinës
Biodiversiteti	Ruajtja e llojeve të cilat janë në rrezik të zhdukjes nga aktiviteti njerzor	1. ndalimi i gjuetis së egër 2. marrja emasave per mbledhesit e bimeve mjekuese 3.Rehabilitimi i sipërfaqeve te pyjore në zonat pyjore dhe ato të gjelbra ne zonat e banimit 5. Krijimi i korridoreve të gjelbra dhe tampon zonave	1. Siperfaqet e reja te krijuara, sip. m ² 2. Siperfaqe te reja, m ² 3.Siperfaqet te rehabilituara, m ² 5. Siperfaqe te kthyer ne zone te gjelber, pjese e koridorrit dhe tampon zona; m ²	1. Raportim 1 here vit 2. Raportim 1 here ne vit. 3. Raportim 1 here ne vit 4. Raportim 1 here ne vit 5. Raportim 1 here ne vit	1. komuna e Klinës dhe MMPH 2. komuna e Klinës dhe MMPH 3. komuna e Klinës dhe MMPH 4. komuna e Klinës dhe MMPH &MBPZHR 5. komuna e Klinës dhe MMPH &MBPZHR dhe Ministria e Infrastrukturës
Ajri	Permireshimi i cilesise se ajrit	1. Ulja e niveli te ndotjes se ajrit per: NOx; CO2 ; O3, PM10. 2. Rruge te asfaltuara rishtas 3. Ulja e nivelt te zhurmave ne zonat e ndjeshme ndaj zhurmave 4. Aplikimi ne banesat e reja i materialeve termizolues dhe mbrojtje akustike	1. Arritja e vlerave te standardit per cilesin e ajrit lidhur me tregusit mbi norme 2. Gjatesia e rrugëve te asfaltuara rishtas 3. Respekt i niveleve te lejuara te zhurmes gjate dites dhe nates 4. Ulja e niveli te zhurmave ne mjediste e banimit	1. Raportim 1 here ne 6 muaj 2. Raportim 1 here ne vit 3. Raportim 1 here ne 6 muaj 4. Raportim 1 here ne vit	1. AMMK dhe komuna e Klinës 2. komuna e Klinës 3. komuna e Klinës 4. komuna e Klinës
Faktoret klimatik	Kursimi i, energjise dhe paksimi i emisioneve te gazeve serre	1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat. 2. Promovimi i paneleve diellor per gjenerim energjie ne ndertesat residenciale dhe sociale dhe energjia e krijuar nga era	1. Siperfaqja e objekteve (m ²) me izolim adekuat 2. Siperfaqja (m ²) e paneleve te instaluar dhe sipërfaqja e ngrohur nga energjia e erës (m ²)	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. komuna e Klinës 2. komuna e Klinës

Uji	Cilesia e ujrave sip.ne perputhje me kerkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives kuadre per ujin te BE	1.Shmangia e shkarkimeve te ujrave te ndotura ne Lumenj 2. Sigurimi i hudhjeve të mbeturinave në lumenj. me qellim ruajtien e niveleve minimal të ndotjes	1a. Vellimi i ujrave qe shkarkohen ne Lumenj; 1b. Vellimi i ujrave mbi normat e lejuara qe shkarkohen Lumenjë; m3. 2. Siperfaqia e ndotjes (m ²) vllimi i mbeturinave (kg ose m ³) ,lloji mbeturinave shkruhet emir i saktë i mbeturinave të forta të gjetura në shtrat të lumit	1.Dy here ne vit 2. Dy here ne vit	1. Komuna e Klinës, AMMK. 2. Komuna e Klinës dhe AKMM
Mbetjet	3)Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi qendrueshem i tyre b) Shnderrimi i pikave te nxehta mjedisore ne siperfaqe te gjelbra/parqe ose zona residenciale	a.1. Pakesimi ne burim dhe riciklimi i mbetjeve a.2. Vendosja e sistemit me disa konteniere per ndarjen ne burim te mbetjeve urbane b.1. Rehabilitim/inkapsulimi i pikave te nxehta ne territoret te mbyllura	a.1. Sasia e mbetjeve urbane/person/vit dhe sasia(ton) e mbetjeve te ricikluara. a.2. Numri i residenteve qe mbulohen nga sherbimi me kontenier b.1. m ² te rehabilituara ose inkapsuluara	a.1. 1 here ne vit a.2. 1 here ne vit b.1. 1 here ne vit	a.1. komuna e Klinës,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjesisht AKMM a.2 komuna e Klinës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjesisht AKMM b.1. komuna e Klinës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjesisht AKMM
Rruget dhe Transporti	Reduktimi i intesnsitetit te trafikut nepermjet promovimit te transportit publik, qarkullimi me bicikleta ku mundet me ndodhë	1.Zgjerimi i rrjetit rrugor per trafikun publik 2. Zgjerimi i rrjetit te korsive per bicikleta 3. Ndertimi i rrugëve te reja me hapsira te pershtatshme trotuaresh (perfshire korsite e bicikletave). Zgjerimi i trotuareve gjate rehabilitimit te rrugëve ekzistuese. 4. Rehabilitim/asfaltimi i rrugëve lokale	1. Km rruge shtese qe mbulohen nga trafiku urban. 2. Km korsi shtese per levizje me bicikleta. Numuri i bicikletave ne qarkullim. 3. Km rruge te reja dhe te rehabilituara. m ² trotuarre dhe korsi bicikletash te shtuara. 4. Km rruge lokale te rehabilituara ose/dhe asfaltuara	1.1 here ne vit 2. 1 here ne vit 3. 1 here ne vit 4. 1 here ne vit	1. Komuna e Klinës ,Ministria e infrastrukturës dhe MMPH 2. Komuna e Klinës. 3. Komuna e Klinës, Ministria e infrastrukturës dhe MMPH 4. Komuna e Klinës.
Trashegimia kulturore	Shtimi dhe mbrojtja e vlerave te kulturore, perfshire ato arkeologjike dhe arkitekturore	Rehabilitimi, mirembajtja dhe ruajtja e objekteve te trashegimise kulturore	1.Numri i objekteve/ndertesave me status mbrojtjes 2. Numri i objekteve/ndertesave te restauruara	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. Komuna e Klinës Instituti për mbrojtjen e Monumeteve 2. Komuna e Klinës Instituti për mbrojtjen e Monumeteve

Trashëgimia natyrore dhe zonat e mbrojtura	Mbrojtja e vlerave të trashëgimis natyrore, llojeve të cilat janë në listën për mbrojtje	Promovimin e vlerave natyrore rekreative, turistike dhe shkencore të këtyre zonave dhe rendesisë së llojeve të cilat janë në Listën për mbrojtje.	Gjetja e formave për sensibilizim dhe kërkime shkencore me të shumta.	1 here ne vit	Komuna e Klinës, Ministria e MMPH-ja dhe instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës
Peizazhi, pyjet dhe toka	1.Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik 2. Mbrojtja e mjedisit natyror në hapësirat për rreth vendbanimeve 3. Ripërdorimi i tokave të ndotura 4.Mirëmbajtje dhe zhvillim i pyjeve 5.Kultivim i pyjeve të reja	1. Shtimi i hapësirave të reja dhe numurit të pemeve e shkurreve. 2. Dhenie e statusi mbrojtje dhe hartimi i një plani manaxhimi mjedisor i ktyre hapësirave. 3. Rehabilitimi i tokave të ndotura(pikat e nxehta mjedisore) dhe venia në efciense për zona të gjelbera/parqe ose rezidenciale 4.Zhvillimi i pyjeve ekzistuese 5. Pyllëzimi i hapësirave të zhveshura	1. Sipërfaqet në m ² dhe numuri i pemeve të mbjella 2.Progresi i zbatimit të planit 3. Sipërfaqe të tokave të ndotura dhe të rehabilituara (m ²) dhe të venit në përdorim sipas PZHK. 4. Sipërfaqe të tokave të zhvilluara pyjore (ha) 4. Sipërfaqe të tokave të re pyjore (ha)	1.Një herë në vit 2. Një herë në vit 3. Një herë në vit 4. Një herë në vit 5. Një herë në vit	1. Komuna e Klinës 2. Komuna e Klinës 3. Komuna e Klinës 4. Komuna e Klinës dhe MBPZHR 5. Komuna e Klinës dhe MBPZHR

PERFUNDIME

Klina shikuar edhe nga aspekti mjedisor në nivel të komunave të Kosovës është vend mjaft atraktiv, për të jetuar, vepruar dhe për të zhvilluar aktivitete tjera jetësore. Është toka kualitative, peizazhet e bukura të parkut Mirusha dhe ujëvarat, peizazhet në luginën e lumit Klina, biodiversitetit, ekosistemeve të veçanta, shtrirja e mbulesave vegjetative nga nivelet me të ulëta deri te zona mesatare. Padyshim që hartimi dhe zbatimi i PZHK-së dhe sugjerimeve të cilat u dalin nga VSM-ja në përgjithësi do të kenë ndikime pozitive në mjedis dhe do të paraqesin përpjekjet më serioze për baraspeshë mjedisore në këtë Komunë .

Duke analizuar PZHK-në e Klinës shihet qartë se PZHK-ja prezanton një profil, koncept të zhvillimit hapësinor, Vizion, prioritete strategjike, strategji e masa zbatimi, në PZHK vërehen edhe përpjekje për të orientuar rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të Klinës bazuar edhe në disa shembuj të përkufizimit të zonave të ndërtimit (jo në definim të zonave në bazë të analizave profesionale) e me qëllim dendësimin në zonat që janë ende në proces zhvillimi dhe kanë synim zgjerimi edhe në zonat e reja të banimit duke marrë parasysh edhe shërbime të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve aktuale në komunën e Klinës.

PZHK-ja ka rrol përmbytësor edhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë së ndërtimeve. PZHK-ja dhe sugjerimet që dalin nga VSM duhet të ndikojnë pozitivisht në revitalizimin e ekosistemeve të degraduara, ripyllëzimin e zonave të zhveshura, pyllëzimin e disa zonave që vazhdimisht janë nën ndikimin e erozionit. Pozitivisht do të ndikoj edhe në ruajtjen e zonave të pasura me ujëra nëntokësore, ekosistemeve të lumenjve nga degradimi dhe nga ndërtimet në brigje të lumenjve.

Gjatë hartimit të VSM-së kemi hasur disa sfida por ndër ato kryesore gjatë hartimit të VSM-së ka qenë, nga se në PZHK bazuar në harta, informata, hulumtime, analiza profesionale dhe ligje nuk janë definuar tregues numerik ose kualitativ për disa pika,vija dhe sipërfaqe të rëndësishme për trajtim adekuat të aspektit mjedisor të planit, vlen të vihet theksi në zonat e zhvillimeve të reja të infrastrukturës (korridoret rrugore, hekurudhore), zona industriale (sipërfaqja), ndikimi i tyre në korridoret e qarkullimit të shtazëve, masa të duhura për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin,zonat me ujëra nëntokësore, zonat me erozion,zonat me deponi dhe ndotje, zonat me mundësi pyllëzimi dhe ripyllëzimi, shiritat e gjelbër, tampon zonat, parqet, tok e ndotur nga pesticidet nuk përmendet as si informatë etj. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden vetëm në pjesën strategjike. Një sfide e veçantë mbetet zbatimi në praktike i këtyre synimeve të PZHK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisore të komunës.

Rekomandimet që dalin nga VSM-ja janë:

- **Definimi në harta i zonave me potenciale rrezatimi por edhe planifikimi i mundësive për trajtimin e rrezatimit dhe uranimit të varfëruar në vendet ku është goditur me bomba në luftën e fundit mendohet të paraqitet si një burim vazhdueshëm i ndotjes në komunën e Klinës;**

- Definimi në harta i zonave erozive dhe të vërshimeve por edhe planifikimi i mundësive, masave dhe projekteve për trajtimin e Erozionit dhe Vërshimeve në aspektin e zonave dhe shkallëve të erozionit;
- Definimi i zonës industriale në aspektin hapësinor dhe të tipit të industrisë dhe krijimit të bazave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm të zonës duke ofruar bazat për trajtim të zonës industriale me masa fizike, natyrore dhe teknologjike që të jetë miqësor edhe në aspektin mjedisor;
- Të definohen në PZHK vendet dhe mundësit, projektet dhe zhvillime për pyllëzim dhe ripyllëzim si mas të rëndësishme mjedisore.
- Definimi në PZHK i zonave, Vijave ose mundësisht edhe pikave të zeza të ndotura nga mbeturinat dhe planifikohen mundësi trajtimi edhe se është përmend riciklimi si një mundësi por ka edhe mundësi tjera, definimi i hapësirave për deponi tranzite dhe sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe proceset tjera.
- Definimi dhe trajtimi si zona konform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujrat nëntokësor dhe sipërfaqësor.
- Definimi dhe trajtimi i koridoreve transportuese në aspektin mjedisor
- Definimi i pejsazheve, parqeve dhe monumenteve tjera me vlera ose ndikime mjedisore dhe parashikimi i masave.
- Trajtimi i ngrohjes së qytetit të Klinës por edhe vendbanimeve si një dimension i rëndësishëm i ndotjes dhe ndikimit në ekosisteme.
- Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë.

LITERATURA

American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010. Standartet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press.

Agjensia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit per vitin 2010.

Komuna e Klinës. 2013 Hartat e prezantuar në PZHK.

Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2009; UNDP- Kosovë

Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2008-2010

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020

Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches.

Qendra Rajonale e Mjedisit. REC.

